



PRANUAR ME:
ACCEPTED ON: 29/06/2026
PRIMLJENO:
Nr.No.Gr. 02/194



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Kuvendi Komunal Malishevë

PROCESVERBAL

i mbledhjes së-III- (tretë) të jashtëzakonshëm të Kuvendit Komunal të Malishevës

RENDI I DITËS

- 1.Shqyrtim dhe miratim i procesverbalit nga mbledhja e kalur.
- 2.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/864 dt.05.06.2026 e parashtruar nga Kryetari i Komunës për ndarjen e mirënjohjeve konform nenit 9 të Statutit të komunës së Malishevës.
- 3.Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitin 2027-2029 me theks të veçantë për vitin 2027.
- 4.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/869 dt.08.06.2026 e parashtruar nga Kryetari i Komunës për funksionin e Organit të Kujdestarisë në Qendrën për Punë Sociale.
- 5.Të ndryshme.

Koha: 12.06.2026, ora 09:26

Vendi: Salla e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës së Malishevës.

Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin: 24 asamblistë, Kryetari i Komunës z.Ekrem Kastrati, Drejtoresha për Arsim dhe Edukim znj.Arbëreshë Krasniqi, Drejtori për Ekonomi dhe Financa z.Blerim Thaçi, Drejtori i Inspektoriatit z.Jakup Gashi, Drejtoresha për Kultur, Rini dhe Sport znj.Teuta Miftari-Mazreku, Drejtori për Mbrojtje dhe Shpëtim z.Nuredin Hoxha, Drejtori për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale z.Amrush Helshani, Drejtori për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural z.Sylë Dukolli, Drejtori për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm z.Arbër Kastrati, Drejtoresha për Prona znj.Mirlinda Gashi, si dhe zyra për informim.

Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Malishevës z.Fatmir Ademaj.

Kryesues i Kuvendit z.Fatmir Ademaj: Përshëndetje për të gjithë! Ne kemi korumin e mjaftueshëm për vazhduarë me seancën e rradhës. I nderuar Kryetar i Komunës, të nderuar antarë të Asamblesë së Komunale mirë se keni ardhur në mbledhjen e tretë të jashtëzakonshme në komunën e Malishevës. Rendin e ditës e keni para vetës. Kush është për?

Rezultati i votimit: 23 për,0 kundër,1 abstenim.

Kryesusi i Kuvendit konstatoi se me shumicën e votave të anëtarëve të Asamblesë u miratua rendi i ditës.

Pika 1

Pika e parë e rendit të ditës: Shqyrtim dhe miratim i procesverbalit nga mbledhja e kalur.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:A ka dikush me debatuarë rreth procesverbalit?Nëse nuk ka kush është për?

Rezultati i votimit: 24 për,0 kundër,0 abstenim.

Kryesusi i Kuvendit konstatoi se Kuvendi i Komunës unanimishtë miratoi procesverbalin nga mbledhja e kaluarë.

Pika 2

Pika e dytë e rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/864 dt.05.06.2026 e parashtruar nga Kryetari i Komunës për ndarjen e mirënjohjeve konform nenit 9 të Statutit të komunës së Malishevës.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:I nderuar Kryetar fjala është për juve.Urdhëroni.

Kryetar i Komunës z.Ekrem Kastrati:Përshëndetje i nderuar Kryesus,të nderuar Asambleistë,të nderuar Drejtorë,të nderuar media ju falenderojë për prezencën e juaj.

Ju sigurishtë që jeni në njohuri që Asambleja komunale ka formuarë një këshillë organizativ i cili ka pasur për detyrë që të kujdeset apo të propozojë para juve personalitetet e dalluara nga tri sferat:për trimëri dhe heroizëm,shëndetësi dhe arsim.

Ky komisionë me të cilën jeni duke e parë e ka bashkangjitur kërkesën me të cilën ju e keni pranuarë materialin.

Këshilli Organizativ për shënimin e 16 Qershorit i cili është themeluarë me vendim të Kuvendit të Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 29.05.2026-të vendosi që në pajtim me nenin 9 të Statutit të Komunës të nominojë këto personalitete me çmimet si në vijimë:

Për çmimin "Imer Krasniqi" për trimëri dhe heroizëm,Këshilli Organizativ vendosi që të dërgojë në Kuvend propozimet e Shoqatës së Veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare-dega në Malishevë.

1.Hasan Zogaj-Lladrov

2.Azem Krasniqi-Pagarush

3.Ferat Shala-Ngucat

4.Sinan Kryeziu-Mleqan

5.Dastan Mazreku-Malishevë

6.Shefket Mazreku-Malishevë

Të propozuarit janë dalluarë për kontributin e tyre në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës duke treguarë guxim, sakrificë dhe përkushtim për shkrimin e vendit. Prandaj konsiderojmë se ata i plotësojnë kriteret morale dhe historike për ti nderuar me çmimin "Imer Krasniqi" për trimëri dhe heroizëm.

Ky propozim ka ardhur nga shoqatat e daluara nga lufta, këta emra të cilat i përmenda ju kemi bashkangjitur edhe biografinë e tyre.

Ndërsa propozimin për çmimin "Hamdi Berisha" me rastin e ditës së çlirimit dhe ditës së dëshmorëve për vitin 2026-të për kontributin e dhënë në shkolla shqipe janë propozuarë këta emra:

1. *Kamer Hoti* – SHFMU "Imer Krasniqi" në Carrallukë
2. *Nysret Hoxha* – SHFMU "Dëshorët e Kombit" në Ngucat
3. *Januz Mazreku* – SHFMU "Ibrahim Mazreku" në Malishevë

Biografia e z. Kamer Hotit

Kamer Hoti ka lindur më 20.08.1959 në fshatin Carrallukë komuna e Malishevës. Ai ishte djali i vetëm i familjes. Kameri u rrit dhe u shkollua në kushte jo të mira ekonomike. Shkollimin fillorë e mbaroi në shkollën "Mustafa Bakija", tani "Hilmi Hoti" në Carrallukë, ndërsa shkollën e mesme e përfundoi në Gjimnazin "Xhevdet Doda" në Rahovec.

Kameri si nxënës i shkollës së mesme ishte shumë i suksesshëm dhe dallohej nga të tjerët në lëmin e leximit, i pasionuar pas literaturës shkollore dhe romaneve me tematikë arsimore dhe kombëtare. Kameri vazhdoi shkollimin e lartë në gjuhë dhe letërsi shqipe në SHLP "Bajram Curri" në Gjakovë. Pas mbarimit të SHLP-së, filloi punën më 01.09.1983 si arsimtar i gjuhës dhe letërsisë shqipe në shkollën fillorë "Mustafa Bakija", tani "Hilmi Hoti" në Carrallukë.

Prej vitit 1992-1994 ishte përgjegjës i shkollës. Përveç përkushtimit të lartë në ligjërimin e lëndës së gjuhës dhe letërsisë shqipe, Kameri ishte ndër më të angazhuarit në çdo lëmi me interes të nxënësve dhe shkollës.

Me punën e tij, në vitin 2002/2003 formoi grupin letrar "Andra Rinije Jonë" në nivel shkolle. Si rezultat i kësaj, çdo vitë doli revista shkollore, si dhe u betuanë dhjetëra vëllime me punime të nxënësve dhe mësime të nxënësve.

Përveç të gjitha këtyre anagazhimeve, ishte i dalluar dhe i suksesshëm në përgaditjen e nxënësve për garat e recitorëve ku, në nivel komunal, për një dekadë dominuanë në vendin e parë.

Me nxënës mori pjesë edhe në garat mbarëkombëtare me nxënësen Shehide Murat Hoti, e cila zuri vendin e dytë në Preshevë, si dhe vendin e parë në garat e penës shqipe në nivel republican me nxënësen Donila Murat Hoti, që u mbajtën në Prishtinë.

Edhe pse në kushte ekonomike shumë të dobëta, me përkushtim të pasqorë punoi pa pagesë në vitet e 90-ta, pa humbur asnjë orë mësimore.

Nxënësi i tij edhe në Olimpiadën e Gjuhës Shqipe zuri vendin e parë në nivel komunal.

U pensionua më 20.08.2024, tani veteran i arsimit.

Biografia e z. Nysret Hoxhës

Nysret Hoxha ka lindur më 28.08.1955 në fshatin Guncat. Shkollën fillorë nga klasa e parë deri në klasën e katër e kreu në vendlindje. Për shkak të kushteve ekonomike, distancës së largët dhe

mungesës së bashkëmoshatarëve për të udhëtuar drejt Banjës,që ishte shkolla amë,vazhdoi mësimin nga klasa e pestë deri në klasën e tetë në fshatin Arllat,tek dajët e tij.

Në vitin shkollor 1971/1972 u regjistrua në Shkollën Normale të Prizrenit,e cila më vonë u shëndërrua në Akademi Pedagogjike.Pas përfundimit të saj,në vitin shkollor 1975/1976 vazhdoi studimet në Shkollën e Lartë Pedagogjike "Xhevdet Doda" në Prizren,në degën Gjuhë Shqipe dhe Letërsi.Studimet i përfundoi me sukses dhe diplomoi në afat rekord në vitin 1977.

Më 1 shtator 1977 filloi punën si mësimdhënës në Shkollën Filllore "Ismail Qemali" në Bellanicë,duke nisur kështu një rrugëtim të gjatë dhe të përkushtuar në arsim.Për dekada me radhë ai dha kontribut të çmuar në edukimin dhe formimin e shumë brezave të nxënësve.

Nga viti 1985 deri më 1990 ushtroi me përgjegjësi të lartë detyrën e drejtorit të Shkollës Filllore "Ismail Qemali" në Bellanicë.Në periudhën 1991-1999 punoi si sekretar i shkollës,ndërsa pas luftës,në shtator të vitit 1999,iu rikthye profesionit të tij të dashur si mësimdhënës.

Në vitin 2005,me pavarësimin e shkollës "Dëshmorët e Kombit" në Guncat,u emërua drejtor i kësaj shkolle të re dhe të rëndësishme për komunitetin lokal.Detyrën e drejtorit e ushtroi deri në prill të vitit 2010,kur u rikthye sërish në mësimdhënie.

Përveç angazhimit në arsim,Nysret Hoxha ka qenë i përfshirë aktivisht edhe në jetën shoqërore dhe organizative të fshatit.Në vitet e 90-ta ishte anëtarë i kryesisë së fshatit dhe i kryesisë së Bashkësisë Lokale.Po ashtu,shërbeu si kryetar i Këshillit të Pajtimit për fshatin Guncat dhe kryetar i Këshillit për Financim në Bashkësinë Lokale të Bellanicës.

Me përkushtimin e tij në arsim,organizim shoqëror dhe çështje kombëtare,Nysret Hoxha mbetet një figurë e respektuar dhe një kontribues i rëndësishëm në edukimin dhe jetën publike të komunitetit të tij.

Me 28 gusht të vitit 2020 pas më shumë se katër dekadash pune dhe përkushtimi në arsim Nysret Hoxha u pensionua duke lënë pas një kontribut të çmuar dhe një trashëgëmi të respektuar në edukimin e shumë brezave.

Biografia e z.Januz Mazreku

Mësuesi Januz Mazreku ishte i lindur më 06.06.1954 në Malishevë,zona e Llapushës.Prindërit e tij ishin Hamzë dhe Hamide Mazreku.Kishte fëmijëri të thjeshtë,me dashuri për dije dhe arsimin.Shkollën fillore e nisi në vitin 1963/64 me mësuesin Izet Zogaj.U avancua nga klasa e katër në të gjashtën për shkak të aftësive.Shkollën fillore e përfundoi në vitin 1969/70.Fillimisht punoi në Rijekë për arsye ekonomike.Me mbështetjen e familjes,u regjistrua në Shkollën Normale të Prizrenit.

Studimet i përfundoi në vitin 1974/75.Shkollimin e përballoi me vetmohim,duke punuar paradite dhe vijuar mësimet pasdite.Filloi punën në arsim në Shkollën "Emin Duraku" në Malishevë.Më vonë u bë drejtor i SHFMU "Ibrahim Mazreku".Për dekada kontribuo në edukimin e brezave,duke u njohur si figurë e respektuar.

I njejt i ishte i burgosur politik për shkak të bindjeve kombëtare.Ai ishte aktiv në lëvizjet arsimore e kombëtare.Ishte Veprimtar i shquar i pajtimit të gjaqeve,duke kontribuar në paqen dhe unitetin shoqëror.Po ashtu kur vendi thërriste për çlirim të vendit u rreshtua në kushtrimin e luftës për liri dhe çlirim kombëtar në rradhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës-Veteran luftëtar i Luftës së Kosovës.Po ashtu ishte i angazhuar në mbështetje të çështjes kombëtare gjatë luftës.Ai ishte i vlerësuar për guximin dhe përkushtimin ndaj popullit.Duke vazhduar misionin e shenjtë prej mësimdhënësi vazhdojë me kontributin e tij në shtet ndërtimin duke punuar mësimdhënës klasor për disa dekada dhe së fundi ka ushtruar pozitën e drejtorit të SHFMU "Ibrahim Mazreku" deri në pensionimin e

plotë më 6 qershor 2019. U nderua për kontributin e tij të jashtëzakonshëm në arsim, politikë, pajtim dhe luftë.

Me punën dhe kontributin e tij të palodhshëm dhe plotë sakrifica personale dhe familjare ka realizuar te këtë trashëgëmi të pasur arsimdashëse, kuturore, kombëtare dhe shoqërore. Po ashtu mësuesi Januz ishte e dha kontribut të drejtpërdrejt edhe në KLMDNJ duke grumbulluar shumë materiale dhe dëshmi për të çjerrë maskën e Jugosllavisë hegjemoniste dhe duke mbrojtur të drejtat e shqipëtarëve që jetonin të okupuar nën këtë shtet gjenocidal.

Mësuesi Januz u pensionua më 6 qershor 2019 duke kontribuar për më shumë se katër dekada punën në arsim dhe veprimtari të veçantë kombëtare. Shumë herë u nderua për kontributin e tij të jashtëzakonshëm në arsim, politikë, pajtim dhe luftë. Gjatë karrierës së tij ka arritur të mbledh edhe të këtë koleksion të shumë këngëve nga rapsodë të Llapushës e më gjerë. Po ashtu ka arritur të ndajë autorësi edhe në librin kushtuar rapsodit Ali Krasniqi e të kontribuojë me të dhëna historike dhe kulturore edhe në disa libratë tjerë me motive kulturore dhe historike. Mësuesi Januz vazhdonë të jetë aktiv edhe pas pensionimit në shumë veprimtari të cilat janë të dobishme për shoqërinë dhe institucionet tona.

Në bazë të kompetencave të Drejtorisë së Shëndetësisë të Komunës së Malishevës, me qëllim të vlerësimit dhe nderimit të personaliteteve për kontributin e jashtëzakonshëm në fushën e shëndetësisë, për nderë të Ditës së Çlirimit dhe Dëshmorëve të Komunës së Malishevës propozonë këto personalitete për çmimin:

Për kontributin e dhënë në Shëndetësi- "Shpëtim Robaj"

1. Ramiz Bytyçi-pas vdekjes-Kravasari(anesteziolog)
2. Dylber Bytyqi-Kravasari-Infermier
3. Shefqet Paqarizi-Dragobil-Infermier
4. Besim Morina-Astrazup-Infermier

Ky çmim ndahet si shenjë mirënjohje dhe respekti për punën, përkushtimin dhe kontributin e dhënë në shërbim të qytetarëve dhe sistemit shëndetësor.

Biografia e z. Ramiz Bytyçit

Ramiz(Tafil)Bytyçi u lind më 6 mars 1949 në fshatin Kravasari, Komuna e Malishevës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa shkollën e mesme të mejkësisë e përfundoi në Prizren. Që në hapat e parë të jetës profesionale u dallua për seriozitet, disiplinë dhe ndjenjë të thellë përgjegjësie ndaj profesionit dhe njerëzve në nevojë. Ai shërbeu për vite me rradhë në shumë fshatra të komunave të Malishevës dhe Suharekës, duke u bërë mbështetje e çmuar për komunitetin.

Në vitet e 70-ta u emërua anesteziolog në Spitalin Rajonal të Pejës, ku dha kontribut të rëndësishëm në shërbimin shëndetësor. Për avancim profesional, u dërgua për specializim të lartë në anesteziologji në Beograd, pas së cilës u kthye dhe vazhdoi punën në Pejë me përkushtim të pandërprerë. Ai njihej si profesionist i sigurt, i qetë dhe i përpiktë, tek i cili pacientët dhe kolegët gjenin besim dhe mbështetje.

Gjatë luftës për çlirimin e Kosovës në vitet e 1998-1999, kontributi i tij mori dimension edhe më të madh njerëzor dhe kombëtar. Ai e shëndërroi shtëpinë e tij në Kravasari në spital ushtarak, ku u trajtuan luftëtar dhe civilë të plagosur. Në kushte jashtëzakonisht të rënda nën rreik

vazhdueshëm, ai nuk u tërhoq asnjëherë nga detyra humane, duke u vënë plotësisht në shërbim të jetës dhe shpresës. Me dije, përvojë dhe guxim, realizoi ndërhyrje të shumta dhe u bë mjek i gjithanshëm në terren.

Ai ishte gjithmonë pranë njerëzve, i gatshëm të ndihmonte në çdo kohë, pa interes dhe pa kërkuar asgjë në këmbim. I thjeshtë në sjellje, i drejtë në qëndrim dhe i madh në vepra. ai ndërtoi marrdhënie respekti e mirësie me të gjithë ata që e njohën.

Ka ndërruar jetë në vitin 2025.

Biografia e z. Dylber Bytyqit

Dylber Bytyqi, i lindur në vitin 1961 në Kërvasari, shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa shkollën e mesme në Prizren.

Punën si Teknik medicinal e filloi në maj të vitit 1980 në Spitalin e Përgjithshëm "Isa Grezda" në Gjakovë, ku punoi deri në vitin 1985. Më pas, me përkushtim dhe humanizëm, hapi ambulancën e tij në fshatin Kërvasari, ku vazhdonë të shërbej edhe sot.

Gjatë gjithë veprimtarisë së tij, ka dhënë kontribut të madh në shërbim të komunitetit dhe çështjes kombëtare. Ai ndihmoi gjatë periudhës së helmimit të nxënësve, ishte aktivist në pajtimin e gjaqeve dhe kontribuoi në organizimin dhe mbështetjen e aktiviteteve në fshat.

Gjatë luftës, u angazhua në rradhët e UÇK-së duke kontribuar në Brigadën 123 dhe Brigadën 60 pranë Shtabit të Përgjithshëm. Po ashtu, vuri në dispozicion shtëpinë e tij, e cila shërbeu si shtab i UÇK-së në fshatin Kërvasari.

Pas luftës, vazhdoi me përkushtim profesionin e tij si Teknik medicinal në shërbim të banorëve të Kërvasarit.

Për kontributin, humanizmin dhe përkushtimin shumëvjeçar ndaj popullit dhe vendit, i shprehim mirënjohje dhe respektin më të thellë.

Biografia e z. Shefqet Paçarizit

Teknik mejkësor, arsimtar i gjuhës shqipe, përkthyes dhe zyrtar shëndetësie. Gjatë një periudhe jo të shkurtër kohore, punoi në Pagarushë, duke u ofruar ndihmë dhjetëra mijëra refugjatë që kishin gjetur strehim aty në verë të vitit 1998-së. Ishte më meritori për shpëtimin e shumë jetëve dhe për mbrojtjen e shëndetit të popullatës.

Në prill 1999, u dëbua në Shqipëri, prej nga u kthye pas luftës. Punoi në QKMF të Malishevës deri në pensionim, më 2015. Ai jetonë ende në Dragobil.

Biografia e z. Besim Morina

Besim Morina ka lindur më 03.02.1970 në Astrazub. Gjatë periudhës mars 1998-qershor 1999, ai ka ushtruar veprimtarinë profesionale si i vetëpunuarë në ordinance private, duke ofruar shërbime radiologjike me aparaturë të rentgenit. Veprimtarinë e tij e ka zhvilluar fillimisht në Ambulancën e vjetër në Malishevë, ndërsa më pas ka vazhduar punën në Pagarushë, nën mbikëqyrjen profesionale të Dr. Agim Hazrollit.

Gjatë kësaj periudhe, shërbimi radiologjik ka qenë në dispozicion të popullatës civile dhe ka kontribuar në ofrimin e kujdesit shëndetësor edhe për pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Puna e tij është zhvilluar në rrethana të vështira të kohës, duke siguruar vazhdimësinë e shërbimeve diagnostikuese për nevojat e komunitetit.

Përmes angazhimit profesional dhe kontributit të tij në fushën e shëndetësisë, Besim Morina ka dhënë një ndihmesë të çmuar në ofrimin e shërbimeve mjekësore për qytetarët gjatë periudhës 1998-1999. Kjo veprimtari përbën një dëshmi të përkushtimit të tij profesional dhe të kontributit në shërbim të komunitetit dhe të interes publik.

Të nderuar Asambleistë këto biografi që i lexova janë propozuarë nga Këshilli Organizativë me të cilën ju e keni themeluarë këtë këshillë, besoj që edhe ju do të vazhdoni me diskutime të mëtutjeshme.

Kryesus i Kuvendit z. Fatmir Ademaj: Faleminderit i nderuar Kryetar. E hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës.

Halil Morina (anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate): Faleminderit Kryesues i Kuvendit për fjalën. I nderuar Kryetar i Komunës, të nderuar drejtorë të drejtorive komunale, të nderuar kolegë Asambleistë me qenëse jemi në prag të festës së 16 Qershorit Ditës së Çlirimit të komunës tonë. Më lejoni që të ju uroj këtë festë të gjithë qytetarëve të komunës tonë të Malishevës. Lavdi të gjithë atyre që kanë rënë për lirinë e vendit të komunës tonë, respekt, nderim e konsideratë për të gjithë ata që kanë luftuarë e kanë dhënë gjymtyrët e veta dhe për të gjithë ata që në qfarë do forme kanë ndikuar për këtë ditë të çlirimit.

E falenderojë Kryetarin e Komunës i cili i lexojë biografitë për personalitetet e propozuara. Ne si grup i Nismës së pari i besojmë Këshillit Organizativ me të cilën ne vetë e kemi zgjedhur po ashtu i besojë edhe organizatës që i ka propozuarë këta emra, për me ju nadër çmimi Shpëtim Robaj dhe dy kategorive të tjera të arsimit dhe shëndetësisë. Ne si grup i Nismës i votojmë pro këta emra.

Unë vetëm e kam një këshillë të vogël që mos të zgjerohen shumë te një kategori sepse i kemi tri çmime për tri kategori të ndryshme është mirë që të jetë numri i njëjtë si në arsim, trimëri dhe shëndetësi sepse te një kategori i kemi katër, te tjetra kategori i kemi gjashtë, te tjetra kategori tri është mirë me bërë njëjtë ndarjen e çmimeve për secilën kategori për shembullë ose gjashtë ose pesë në mënyrë që mos me i hyrë në hak askujt. Mirëpo meqenëse jemi afër festës festive ne i votojmë pro të gjitha këto propozime. Faleminderit.

Burim Paçarizi (anëtarë nga rradhët e Partisë Demokratike të Kosovës): Faleminderit Kryesus. Përhëndetje i nderuar Kryetar, të nderuar kolegë. Sot është një ditë e rëndësishme për komunën e Malishevës por edhe për Kosovën sepse është Dita e Çlirimit, ju uroj të gjithë qytetarëve të Kosovës këtë festë, gjithashtu e kemi afër edhe Ditën e Çlirimit të Malishevës 16 Qershorin i uroj të gjithë qytetarëve tonë për këtë festë meritore dhe të gjithë ata dëshmorë, familjet e dëshmorëve, martirëve, ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe të gjithë ata që kanë kontribuarë në cilën do formë për çlirimin e vendit tonë i kanë meritat më të larta që ne sot e gëzojmë këtë liri. Faleminderit Kryetar për prezantimin e të gjithë atyre emrave, me të cilën janë më se meritore.

Ne si Parti Demokratike e Kosovës e vlerësojmë lartë kontributin e të gjithë atyre pa dallim me emra, besojë që komisioni ka bërë vlerësimin e duhur për këta kandidatë të cilët e meritojnë dhe ne i mbështesim të gjithë njëjtë për këto tri kategori për çmimin "Imer Krasniqi", "Hamdi Berisha" dhe "Shpëtim Robaj" janë tri medalje që komuna jonë ka shpërndarë në vazhdimësi këto mirënjohje sepse ata kanë qenë njerëz profesionistë që kanë punuar pa paga, kanë punuar në aspektin huamnë

për të mbajtur gjallë virtytin për Çlirimin e Kosovës,po ashtu kanë kontribuarë në arsim dhe shëndetësi ne i mbështesim këta emra pa i përmendur emrin e seclit.Prezantimi i biografisë për këta emra ishte i mirë.Faleminderit shumë.

Veton Zogaj(anëtarë nga rradhët e partisë Lëvizja Vetëvendosje):Përshëndetje Kryesus.Faleminderit për fjalën.Përshëndetje Kryetar,të nderuar drejtorë dhe ju kolegë Asambleistë.Ne si grup parlamentar e mbështesim kërkesën e Kryetarit dhe aprovimin e Këshillit Organizativ.Në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa i kam propozuarë disa sygjerime apo rekomandime për herat e tjera,në këtë seancë do të mundohem që shkurtë me i përmbledhur.Në Statutin e Rregullorës së komunës e kemi rritur numrin për ndarjen e çmimeve në tri kategori,mirëpo nuk pajtohem me Këshillin Organizativ me ndarjen e çmimeve që e ka bërë në mënyrë jo propocionale,te kategoria e shoqatës të dalura nga lufta i ka përzgjidhur gjashtë kandidatë,te kategoria e arsimit tre kandidatë dhe te kategoria e shëndetësisë katër.

Nëse e vendosim një parim duhet me qenë tri për secilën kategori nuk është mirë me shkuarë ndoshta edhe më shumë sepse evalvonë pastaj si çmim ose nëse e vlersojnë shoqatat e dalura nga lufta që duhet me ju ndarë më shumë kandidatëve këtë çmim atëherë duhet me ju ndarë kompletë një batalioni dhe e marin kompletë çmimin ajo njësi e ushtrisë ose ata vetereanë të ushtrisë.Mirëpo kjo formë si i keni ndarë nuk më duket në rregullë,megjithatë respekt e falenderim për secilin emër që është këtu,shumicën e tyre i njohim personalishtë,i nderojmë dhe i respektojmë kudo që janë sot.Unë e kam një pyetje emrat që janë nominuar për ndarjen e çmimit për heroizëm dhe trimëri janë propozuar nga Këshilli Organizativ,dëshirojë me ditur emrat që janë nomuar për ndarjen e çmimit në arsim dhe shëndetësi këta emra që janë nomuar a kanë ardhur nga drejtoria përkatëse apo nga Kryetari?Unë nuk e kam të kjartë këtë pjesë nëse ka mundësi Kryetari me na shpejguarë.Faleminderit.

Enver Hot(anëtarë nga rradhët e partisë Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës):Faleminderit Kryesus.I nderuar Kryetar faleminderit për prezentimin që e keni bërë ato janë propozime shumë të rëndësishme.Të nderuar Asambleistë,të nderuar qeverisje komunale,sot jemi në pragë të festës më të rëndësishme të komunës tonë Ditës së Çlirimit 16 Qershorit,po ashtu jemi në festën e 12 Qershorit Ditës Çlirimit të Kosovës urime të gjithë qytetarëve të Kosovës.Uroj që këto festa të vijnë gjdo herë e më të mira e më kompakte e më të zhvilluar për vendin.Këto tri çmimi që do të ndahenë na jepim një kujtesë të lavdishme për kombin tonë,gjithashtu jepim motiv për brezat e rinjë se si duhet me punuar dhe vepruar në të gjitha fushat për interesin e qytetarëve.

Unë besoj fuqishëm në institucionet tona në këto organizta siq është shoqata e veteranëve,sindikata e drejtorisë së arsimit dhe sindikata e drejtorisë së shëndetësisë ata e kanë bërë punën më të mirë të mundshme.Sa i përket numrit të veteranëve që i kanë nominuar është i vogël sepse kemi shumë që kanë luftuar kurse dita ditës ata nuk po janë më në mesin tonë,ne mund ti nderojë jo vetëm me çmime por edhe me vepra të tjera është mirë me i nderuar ata sa jenë ende gjallë.Faleminderit edhe një herë Krytar dhe atij grupi që kanë punuar për zgjedhjet e nominimit të atyre emrave që kanë luftuarë për çlirimin e vendit.

Në mesin e Malishevës kanë kontribuarë shumë për çlirimin e Kosovës por jo vetëm aty por kanë dhënë një kontribut të rëndësishëm edhe në luftën e ushtrisë çlirimtare për Preshevë,Medvegjë e Bujanovc për qështje kombëtare.Prandaj në këtë Ditë të Çlirimit të Malishevës do të ishte mirë me

i nderuar edhe ata që janë denuar me burgim të përjetshëm do të ishte mirë që emrat e tyre me qenë këtu me i nderuar me mirënjohje për heroizëm dhe trimëri dy emra Muhamet Krasniqi dhe Esat Kapigjollli. Gjithashtu Kryetar porpozojë që si institucion i Malishevës të fillojmë me bërë diqka për ata sepse shteti po heshtë, prandaj në aspektin juridik në aspektin moral si bashkëvendasë me dal me ju tregu se qfarë mundemi me bërë si institucion dhe si qytetarë do të duhej dhe mendoj që është mirë që emrat e atyre të përfshihen në mirënjohje për punën e tyre sepse ata janë pjesëmarrës të luftës së vitit 2001 dhe luftës së Kumanovës ata kanë bërë një mekanizëm kanë bërë një lavdi për trojet shqiptare për amanetin e lidhjes së Prizrenit dhe për betimin e ushtarit të UÇK-së. Mendoj dhe propozoj që të përfshihen këta dy emra për çmimin "Imer Krasniqi" për trimëri dhe heroizëm. Faleminderit.

Fitim Shala (anëtarë nga rradhët e partisë Lidhja Demokratike e Kosovës): I nderuar Kryesus, i nderuar Kryetar, të nderuar drejtorë, të nderuar Asambleistë. Meqenëse jemi në Ditën e Çlirimit të Kosovës dhe në prag të Ditës së Çlirimit të Malishevës ju urojmë të gjithë qytetarëve këtë ditë. Në këtë ditë i kujtojmë dhe i nderojmë të gjithë dëshmorët dhe martirët e kombit tonë, falenderojmë të gjithë veteranët dhe gjithë këtë popull shqiptar që ndihmuanë dhe sakrifkuanë për çlirimin dhe lirin e Kosovës.

Ne do të ja jepim mbështetjen e plotë Këshillit Organizativ për festimin e 16 Qershorit dhe propozimeve për çmimet vjetore të Kuvendit, çmimi "Imer Krasniqi", çmimi "Shpëtim Robaj" dhe çmimi "Hamdi Berisha". Natyrisht ndjehem mirë që jam pjesë e kësaj legjislature dhe në mes e këtyre çmimeve kam mundësi ta ngriti dorën edhe për ish mësuesin tim z. Nysret Hoxha dhe njëri prej luftëtarëve më të vjetër në fshatin Ngucat z. Ferat Shala. Nderime dhe mirënjohje për të gjithë ata që u flijuanë dhe u sakrifkuanë për lirin e vendit tonë. Faleminderit.

Hafir Rexha (anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate): Faleminderit Kryesus. Përshëndetje Kryetar, drejtorë, kolegë Asambleistë, qytetarë të Malishevës. Urime Dita e Paqes. Unë për rendin e ditës i kam pregaditur dy fjalime, njëra që është më shumë në formë të pyetjeve ose me thënë më thjeshtë si një rekomandim për organizatën e OVL-së së UÇK-së dega në Malishevë nëse ata do të ishin prezentë do të ju thoja komplotë fjalimin por këtë do të përpiqen vetëm në pika të shkurta por gjerësisht do të ju dërgoj me shkrim atyre sepse Malisheva e ka një territor bukur të madh prej fillimit të ndarjes së çmimeve për trimëri dhe heroizëm, për arsim dhe për shëndetësi në zonën nga vijë unë nuk është përfshirë asnjë personalitet.

Kështu që nganjëherë i bëjë pyetje vetë vetës a thua kemi qenë ne në atë pjesë a jemi pjesë e Malishevës edhe pse jemi në fund atje? Kjo pyetje shkonë për Organizatat e dalura nga lufta sepse ne dimë që e kemi formuar këtë komision dhe ju kemi dhënë besimin dhe emrat i propozonë shoqatat e dalura nga lufta. Pra edhe ne atje nga zona e cila vijmë ne, kemi qenë njësia e parë e themeluar e UÇK-së me pseodonim të emrit Çeliku pesë atje ka pasur komandantë ka pasur shumë njerëz që e meritojnë këtë çmim, gjithashtu edhe në shëndetësi kemi veterane e cila është dhe ka shërbyer edhe pas luftës. Gjithashtu kemi mësime dhënë që kanë dhënë kontributë e që tani janë pensionuar dhe ende nuk ju ka ardhur rradhja për me ju ndarë mirënjohje.

Por si do që të jetë kjo është formë kritike dhe sygjjerimi për Organizatat e dalura nga lufta le të shohin në të gjitha rregjionet sepse është pakë qfarë janë duke bërë për ushtarët. Unë kisha propozuar që për me i zënë të gjithë ushtarët e gjallë këtu me formuluar një model pak më

ndryshe me i përfshirë siq e tha njëri prej parafolësve ose në bazë të njësisë ose në kuadër të brigadës me gjetur një lloj modaliteti sa janë ata ende gjallë dhe me i shpërblyer për kontributin që e kanë dhënë ata. Ky fjalimi imi i parë ka qenë kritikë, mirëpo për hir të situatës Ditës së Çlirimit që jemi do të mbetet kështu sipërfaqësorë dhe në qoftëse vazhdohet kështu, ne si Asambleistë e dimë që përfaqësuesit që kanë qenë atje i kanë marrë emrat e gatshëm mirëpo nuk duhet me i marrë emrat në forma grupe ose në formë të muhabetëve sepse lufta është zhvillur cepëm cepë në komunë të Malishevës.

Ndërsa për çmimet e tanishme të nderuar familjarë të dëshmorëve, veteranë të luftës, qytetarë të komunës së Malishevës, në këto ditë të shenjëta siq është 16 Qershori Dita e Çlirimit, Dita e Dëshmorëve përulemi me respektë dhe krenari para veprës madhështore të bijëve dhe bijave që dhanë jetën për liri që ne e gëzojmë sot.

Kjo ditë na kujtonë sakrificën të dëshmorëve tanë të cilët me guxim, trimëri dhe heroizëm shkruanë historinë më të lavdishme të kombit tonë. Lavdia e tyre do të mbetet e pavdekshme në zemrat tona dhe në historinë e Kosovës. Sot kemi nderin e veçantë që të ndajmë çmimin për trimëri dhe heroizëm "Imer Krasniqi" një emër që simbolizonë qëndresën, guximin dhe përkushtimin ndaj atdheut. Ky çmim nuk është vetëm një mirënjohje por është një amanet për brezat që ta duanë dhe ta mbrojnë me dinjitet vendin e tyre.

Në emrin tim si Asambleistë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate dhe në emër të qytetarëve që i përfaqësojë shprehim respektin dhe falenderimin më të sinqertë për të gjitha familjet e dëshmorëve, invalidët e luftës, veteranët e luftës dhe të gjithë ata që kontribuanë për lirinë e Kosovës.

Malisheva gjithmonë ka qenë vatër e patriotizmit dhe sakrificës, ne e kemi obligim moral dhe kombëtar që të ruajmë kujtimin për dëshmorët tanë dhe të punojmë gjdo ditë për Kosovën e zhvilluar, të drejtë dhe të fortë. Lavdi e përjetshme dëshmorëve të kombit. Urime 16 Qershori Dita e Çlirimit në Malishevë.

Kryesues i Kuvendit z. Fatmir Ademaj: Fjalën ja kalojë Kryetari të Komunës z. Ekrem Kastrati.

Kryetar i Komunës z. Ekrem Kastrati: Faleminderit të gjithëve për këto diskutime, me të vërtetë numri i këtyre kandidatëve që janë propozuarë është shumë i vogël sepse qytetarët e Malishevës gjatë gjithë historisë kanë kontribuar shumë në të gjitha aspektet si në patriotizëm, arsim dhe shëndetësi. Ne jemi duke diskutuar me Shoqatat e dalura nga lufta dhe me 30 dhjetor është Dita e Veteranit ne do të ja bëjmë disi kësaj pune që të përfshihenë të gjithë veteranët me mirënjohje dhe me respektë. Mirëpo ne jemi në modifikim të kësaj date të ndarjeve të mirënjohjeve për trimëri dhe heroizëm dhe besoj që së bashku me këto organizata do ka kemi një pajtim që ndoshta do të përfshihen propozimet e Asamblesë, ne do të marrim një vendim që me pasur një gjithë përfshirje që me pasur një unitet të gjithë spektrit politikë.

Ne do të jemi në diskutim se si me ja bërë kësaj pune besoj që propozimet e juaja do të aprovohenë dhe Ditën e Veteranëve me 30 dhjetor ti thërrasim dhe ti shpërndajmë medalje.

Ju jeni duke e parë që edhe shoqërisë civile kemi nevojë me i ndarë mirënjohje për trimëri dhe heroizëm për shembull një aksident trafikur që ka ndodhur afër Carrallukës i ka shpëtuar një qytetarë tri jetë duke i dhënë ndihmën e parë dhe kur kanë shkuarë në QKMF për trajtim të

mëtuftjeshëm mjeksor i kanë thënë:ndihma e parë që është bërë në vendin e ngjarjes ka qenë esenciale që këta njerëz janë gjallë,prandaj ai njeri i cili i ka shpëtuar tri jetë meritonë këtë mirënjohje për trimëri dhe heroizëm.

Ne e kemi rastin tjetër kur tri anëtarë të familjes që u dogjën brenda në ndërtesë një puntor i shëndetësisë ai e ka rrezikuar vetë jetën për me i shpëtuar,ai e meritonë të shpërblehetë për trimëri dhe heroizëm.Pra kemi njerëz nga shoqëria civile që meritojnë të shpërblehen për trimëri dhe heroizëm.Mirënjohjet që do të ndahen për kontributin e dhënë në arsim dhe shëndetësi këta emra i kanë propozuarë drejtoritë përkatëse në këtë rast nga drejtoria e arsimit dhe drejtoria e shëndetësisë dhe nga OVL-ja.

Te ne kanë ardhur këta emrat e propozuar e që sot kërkohet aprovimi i tyre.Ju falenderojë edhe njëherë të gjithëve për kontributin e dhënë,unë do ti trajtojë të gjitha qështjet me kujdes dhe ndjeshmëri pra gjithmonë do të jem në interes për juve dhe të gjithë qytetarëve të komunës së Malishevës,sot po e shfrytëzojë rastin edhe unë që me ju uru të gjithëve Ditën e Çlirimit të komunës së Malishevës,ditën më të prestigjioze dhe më madhështore që e kanë qytetarët tanë.Urime kjo festë respektë për të gjithë ata njerëz që kanë dhënë shumë ne duhet të mundohemi që edhe më shumë me realizuarë për shtetin tonë që me shkuar amaneti i tyre që kanë kontribuarë për atëdhe.Lavdi dhe respekt për të gjithë dëshmorët e kombit.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Sa i përket propozimit të z.Enver Hotit,kërkojë që të kjarhtësohet se a dëshironë me propozuarë apo ti përkrahë propozimet e Këshillit Organizativ në të cilën ka pasur unitet nga të gjitha subjektet politike të përfaqësuesve të politikës,mbetet të deklarohet z.Enver Hoti se a dëshironë me vendosur në votim propozimin e tij individualë apo të Këshillit Organizativ?

Enver Hoti(anëtarë nga rradhët e partisë Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës):Faleminderit Kryesus.Unë isha i kjarhtë,natyrisht propozimet që kanë ardhur nga Këshilli Organizativ,unë si përfaqësues nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës i mbështeti dhe propozojë që Ditën e Çlirimit z.Esat Kapigjollit dhe z.Muhamet Krasniqit të nderohenë me mirënjohje me çmimin për trimëri dhe heroizëm.Ata janë duke kaluarë momente më të vështira të jetës së tyre,ata janë duke u përballur me dhunën dhe torturën,ata janë duke u përballur me probleme shëndetësore dhe me datën 16 Qershor është ajo më e pakta që ne mundemi me bërë për ta me ju ndarë çmimin.Unë e kam këtë propozim që të dekorohenë me këtë çmim.Faleminderit.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Atëherë ashtu siq e ceku propozimin z.Enver Hoti që të ndahen mirënjohje për z.Esat Kapigjollin dhe z.Muhamet Krasniqi për çmimin "Imer Krasniqi",kush është për?

Rezultati i votimit:26 për,0 kundër,0 abstenim.

Kryesusi i Kuvendit konstatoi se u miratua unanimishtë nga anëtarët e Kuvendit propozimi që të ndahen mirënjohje për dy kandidatët.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Atëherë i hedhim në votim në tërsi propozimet e Këshillit Organizativ,propozimet e Drejtorisë së Arsimit,Drejtorisë së Shëndetësisë si dhe dy emrat e propozuarë nga e z.Enver Hotit.Kush është për?

Rezultati i votimit:26 për,0 kundër,0 abstenime.

Kryesusi i Kuvendit konstatoi se u miratua unanimitisht nga anëtarët e Kuvendit kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesusi i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Urime Dita e Çlirimit njëkohësishtë Dita e 16 Qershorit,urojë që kjo festë të na gjejë gjithmonë të bashkuarë.

Pika 3

Pika e tretë e rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitin 2027-2029 me theks të veçantë për vitin 2027.

Kryesusi i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Fjalën ja kalojë z.Blerim Thaçi Drejtorit për Ekonomi dhe Financa.

Blerim Thaçi(Drejtor për Ekonomi dhe Financa):Faleminderit Kryesus,shfrytëzojë rastin të ju uroj Ditën e Çlirimit dhe Ditën e 16 Qershorit të gjithë qytetarëve.Sipas ligjit për planifikim buxhetor e qarkorës së parë e cila duhet me qenë në muajin qershor,ne i kemi pregaditur sipas udhëzimeve na Ministria e Financave.Në vitin 2025-të si planifikim i buxhetit është parashikuarë ngritje e vogël prej 4.86% e totalit të buxhetit në krahasim me vitin 2026-të.Rritjet janë kryesishtë në administratën e përgjithshme e cila është 10.76% te grandit i arsimit kemi zvogëlim për 0.86%,te grandit i shëndetësisë kemi rritje prej 2.88%,te shërbimet rezidenciale kemi 0.66%,të hyrat vetanke janë planifikuarë që të rriten për 6.57% si total i ngrites së buxhetit për vitin 2027-të është 4.86% vlera totale 23,161,855.00€.

Sipas asaj qarkore që është prezantuarë para juve janë ndarë në pesë kategori:paga dhe shtesa kemi 13,317,402.00€,mallra dhe shërbime i kemi 2,700,000.00€,shpenzime komunale i kemi 550,000.00€,subvencione dhe transfere i kemi 600,000.00€ dhe shpenzime kapitale i kemi 5,994,452€ që vlera totale i bie 23,161,855.00€ ky është prezantimi i kabit 1 për të cilën kërkojë nga ju me aprovuarë,por njëkohësishtë e kemi edhe një kërkesë nga drejtoria e arsimit që ka ardhur me vonesë,ditën e djeshme,ne e kemi prezantuarë para Kryesusit,por unë do ta prezantojë edhe para juve është mirë të aprovohetë mirëpo a na lejohet a jo kjo duhet me kaluar në Kuvend është kërkesa e drejtorisë së arsimit për funksionalizimit e tri çerdheve në Banjë,Bellanicë dhe Dragobilë për të cilën kërkohet rritja e numrit të stafit që të bëhenë funksionale këto tri çerdhe dhe pa miratim dhe planifikim të buxhetit për vitin 2027-të nga Kuvendi i Republikës së Kosovës këto nuk mundën të funksionalizohenë pa stafin e tyre pedagogjikë, profesional dhe teknik.

Aty bëjnë pjesë stafi administrativ,edukatorët,stafi teknik që përfshinë edhe te puntorët e kuzhinës kështu që kërkojë që këtij kapi ti shtohet edhe kjo pjesa e drejtorisë së arsimit për rritjen e numrit të stafit të arsimit posaqësishtë për tri çerdhet.Faleminderit.

Kryesusi i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit Drejtor,kjo kërkesa e Drejtorisë së Arsimit a trajtohet në kuadër të kërkesës tuaj?

Blerim Thaçi(Drejtor për Ekonomi dhe Financa):Po,secila drejtori e ka pasur të dërguarë në email por edhe fizikishë qarkoren buxhetore për të cilën është kërkuarë të sjellin kërkesat e tyre

që ti fusim në kabin 1, mirëpo drejtorja e arsimit me vones na ka sjellur dhe tani nëse votohet kjo sot në kuadër të saj me këtë kërkesë, ne e fusim në planifikim buxhetor dhe e dërgojmë në Ministri sipas aprovimit të juaj. Një gjë është duke u kërkuarë dëshironi me aprovuar e fusim në planifikim të qarkores, nëse nuk e vendosni ajo për vitin e ardhshëm mbetet i pa funksionalizurë.

Hafir Rexha (anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate): Përshëndetje Kryesus, Drejtor, të nderuar Asambleistë. Unë për këtë ditë për këto pika të rendi të ditës nuk kam material. A është qështja e problemit të sekretarisë së Kuvendit për materialim që nuk më ka ardhur, në email më ka ardhur vetëm rendi i ditës dhe kërkesa e Kryetarit.

Këtu është një komunë dhe nuk duhet me na vendosur neve në një pozitë të pa lakmueshme sepse ne nuk jemi duke e ditur se qfarë jami duke bërë, ju keni pasur afatë një muaj me pregaditur, unë në cilësinë e asambleisti nuk jam duke e ditur a me ngritur apo mos me ngritur dorën sepse nëse votoj nuk jam duke e ditur se qfarë jam duke votuarë, unë jam duke i besuarë fjalës së z. Blerimit mirëpo letrës nuk jam duke i besuarë, dëshiroj me pasur në letër le të mësohemi. Unë për këtë pikë nuk jam duke e ditur se qfarë jam duke bërë apo qfarë me thënë, tri dhjetë ditë ka dallim seanca nga seanca dhe ju ditën e fundit e sjellin materialin në Kuvend, nuk lejojë kështu. Në emrin tim unë nuk e votoj.

Veton Zogaj (anëtarë nga rradhët e partisë Lëvizja Vetëvendosje): Faleminderit Kryesus. Kornizën afatmesme buxhetore e kemi diskutuar edhe në mbledhjen e KPF-së, Drejtor disa dilema i kam pasur atë ditë nëse keni mundësi me ja dhënë sot disa shpjegime. Buxheti prej 23,161,855.00€ është i parashikuarë si shumë totale për vitin 2027/2029, a ka mundësi që kjo shumë të rritet apo të zvogëlohet kur të vie qarkorja buxhetore e dytë e cila pritet me ardhur në muajin gusht? A do të jetë ky buxhet i cili na përcjellë që ne me miratuarë për muajin shtator? Te disa kategori vërehet që ka rënje për shembullë te kategoria e arsimit a është zvogëluarë numri i nxënësve apo është numri i njejtë edhe i fëmijëve?

Përderisa e keni sjellur kërkesën e drejtorisë së arsimit duhet me dhënë një shpjegim më të kompletuarë nëse në këtë kërkesë e vendosim me futur sot në kabin 1. Kërkesa është që me rritur numrin e stafit për tri çerdhet publike e cila pritet me u hapur në muajin shtator. Sa është numri i stafit që po kërkohet këtu? Sa edukator/e dhe sa ndihmës teknik janë duke u kërkuarë?

Duhet me ditur numrin e saktë dhe jo vetëm kërkesa me qenë blanko, pa e ditur për afërsisht sa kosoto buxhetore nevojitet për kërkesën për të cilën do ta votojmë. Ne e dimë që në vazhdimësi jemi duke u përballur me përmbaruesin privat e që komunës jo pak është duke ja marrë buxhetin në secilën kategori në secilin vit me rradhë. Si e keni parashikuarë ju që me i mbuluarë këta sintoma si keni me i mbuluarë pagat e punëtorëve nga secili sektorë, nëse ne kemi me u përballurë me përmbaruesin që vijnë nga kërkesat kolektive?

Shuma prej 23,161,855.00€ mendojë që është shumë e pamjaftueshme për me i mbuluarë të gjitha ato kategori që krijonë shpenzime për shembullë te pagat e kështu me rradhë. Faleminderit shumë.

Burim Paqarizi (anëtarë nga rradhët e Partisë Demokratike të Kosovës): Përshëndetje kolegë. Unë e kam një pyetje për Drejtorin para se me filluar te kabin 1. A ka ndonjë planifikim në drejtorinë e arsimit dëshiroj me ditur saktë sa puntorë nevojiten? Me sa e di unë që kam njohuri

këto tri çerdhet, kanë sipërfaqe jashtëzakonisht të madhe dhe ju nevojitet një numër i madh i stafit të edukatorëve, staf teknik, kuzhinera, mirëmbajtës.

Unë jam duke e vërejtur që drejtorja e arsimit nuk ka mundur me sjellur raportin edhe pse për shembullë çerdhja e Banjës është e gatshme për të funksionuar që dy vite ajo ka inventarë ka mbetur vetëm me marrë një miratim për energji elektrike. Do të ishte mirë që këto punë me ardhur me një raport të mirë që ne me ditur, ashtu siq e ceku edhe kolegu me ditur se qfarë jemi duke votuarë.

Do të ishte mirë me pasur një raportë dhe me ditur se qfarë është duke u planifikuar dhe pastaj ne si kolegë te ngrisim presionin te Ministria që ta realizojë ose ta mundësojë rritjen e stafit për këto çerdhe që janë më se të nevojshme. Unë e vëretje te kategoria e arsimit që është zvogëluarë buxheti dhe çerdhja i përket sektorit të arsimit, çerdhet kanë një kosto jashtëzakonisht të lartë si objekte shkollore për shkakë që ata kanë nevojë gjdo ditë për furnizime për ushqim dhe gjëra të tjera elementare, nuk është e njëjtë sikur te nxënësit ashtu edhe te fëmijët, aty ka një kosto më të lartë. Të formulohetë një planifikim i mirëfilltë, në këtë rast kërkojë një shpjegim më të nga drejtori. Faleminderit.

Hafir Rexha (anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate): Unë e kam një pyetje për Drejtorin. A është urgjente kjo kërkesë? A ka mundësi në seancën e ardhshme me na ardhur e kompletuarë? Nëse është urgjente ne do të bëjmë diqka, nëse nuk është urgjente për mbledhjen e ardhshme me na ardhur e detajuarë.

Blerim Thaçi (Drejtore për Ekonomi dhe Financa): E para z. Hafir unë e di që materiali për kabinat ju ka ardhur të gjithëve. Buxheti prej 23,161,855.00€ është caktuarë ky limit, drejtorja e arsimit ka kërkuarë që kjo kërkesë përmes Asamblesë me u votuarë dhe pastaj me drejtuarë në Ministri. Në atë formë kur shkonë në Kuvend me amandamentin, sepse ne kemi pasur rastin që kur kemi hapur çerdhe këtu, propozimi ka qenë i deputetëve tonë atje me sa më kujtohet ka qenë viti 2018-të për rritjen e stafit për 16 puntorë për shkakë që me funksionalizuarë çerdhen atje është bërë ndryshimi në Kuvend, ne përtej kufijëve nuk mundemi me dalur.

Kjo kërkesë e drejtorisë së arsimit përmes juve ju drejtohet Ministrisë së Financave që ta mundësojë rritjen e buxhetit për shkakë të hapjes së çerdhes. Ata ju kanë drejtuarë edhe Ministrisë së Arsimit, mirëpo ne me ju thënë të drejtën nuk kemi përfaqësues të Nismën në Kuvend pra nuk kemi përfaqësues të drejtë për drejtë aty sepse ne ndoshta do të kishim kërkuarë edhe rritje për buxhet.

Burim Paqarizi (anëtarë nga rradhët e Partisë Demokratike të Kosovës): Komuna e Rahovecit për katër vite ka arritur me i funksionalizuarë katër çerdhe brenda dy viteve.

Blerim Thaçi (Drejtore për Ekonomi dhe Financa): Me vetë faktin që kemi zvogëlim në buxhet nënkuptonë që kemi më pak nxënës dhe kjo nënkuptonë që kemi shuarje të vendeve të punës. Ministria e bënë një lloj politike një lloj harmonizimi. Kërkesa e drejtorisë së arsimit është plotësisht e arsyeshme sepse një mësimdhënës i cili punonë përshembullë në Panorci i shuhet vendi i punës ai nuk ka mundësi me punuarë kuzhinerë në çerdhe. Prandaj është kërkesa e drejtorisë së arsimit që të rritet numri i stafit nëpër çerdhe.

Veton Zogaj(anëtarë nga rradhët e partisë Lëvizja Vetëvendosje):Ne jemi për me votuarë kërkesën e drejtorisë së arsimit,mirëpo kërkojmë me qenë e specifikuarë me na treguarë saktë sa kërkohet numri i stafit.

Blerim Thaçi(Drejtor për Ekonomi dhe Financa):Unë nuk e lexova kërkesën z.Veton mendova se ju e keni këtë kërkesë.Drejtorja e Arsimit për tri çerdhe publike ka kërkuarë staf për 18 pozita,edukator/e nevojiten 7,edukator/e mbështetës nevojitet 1,asistent/e për nevoja të veqanta nevojiten 2,psikolog/e dhe pedagog/e nevojitet 1,drejtor/shë nevojitet 1,në administratë nevojitet 1,kuzhinier/e nevojitet 1,ndihmës kuzhiner/e nevojitet 1,mirëmbajtës nevojitet 1,sigurim nevojitet 1 dhe mirëmbajtës teknik 1,ju kërkojë falje që nuk e prezentova në fillim pra nevojitet për 18 pozita.

Hafir Rexha(anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):A ka mundësi që kërkesën e Drejtorit për Financa dhe Ekonomi me trajtuarë sot kurse kërkesën e Drejtorisë së Arsimit me na sjellur të kompletuarë dhe më të detajuarë për seancën e ardhshme për trajtim?Ne pastaj do të kërkojmë edhe më tepër se sa kanë lypur ata për tri objektet e çerdheve,ne do ta modifikojmë pak më shumë.Unë propozojë që pika e rendit të ditës të Drejtorisë së Financave dhe Ekonomisë të votohet të kalojë,ndërsa kërkesa e Drejtorisë së Arsimit të na vijjë në seancën e ardhshme.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Ne jemi duke u bazuar në Rregullore dhe ligj për shqyrtim dhe miratim të kornizës afatmesme buxhetore,unë për momentin jam në kontakt me Drejtoreshën e Arsimit,janë dy qështje ose duhet me u trajtuarë në kuadër të kërkesës së Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa që duhet me u pajtuarë ose ajo nuk ka logjikë që kjo kërkesë me u trajtuarë si pikë tjetër ose te pika të ndryshme.A dëshironi me u pajtuarë që me bashkangjitur kërkesën e drejtorisë së arsimit me kërkesën e drejtorisë për ekonomi dhe financa?

Veton Zogaj(anëtarë nga rradhët e partisë Lëvizja Vetëvendosje):Unë kërkojë nga z.Muharrem Morina me na dhënë një interpretim ligjor.A kemi mundësi që kërkesën e drejtorisë së arsimit me përfshirë në kabin 1 në kornizën e parë buxhetore?Apo kemi mundësi që kërkesën e drejtorisë së arsimit me përfshirë në kornizën e dytë buxhetore?

Blerim Thaçi(Drejtor për Ekonomi dhe Financa):Ne e kemi afatin e fundit ligjor me dorëzuarë deri më 30 Qershor në Ministri,pasi e dorzojmë në Ministri neve na ftojnë për takim për konsultime,pse na duhen ato lëvizje.Ne si Drejtori për Ekonomi dhe Financa me aprovuarë kërkesën e Drejtorisë së Arsimit nuk kemi mundësi me i punësuarë në 57 pozita,por këtë numër ka mundësi me rritur vetëm Kuvendi.Se a mundemi ne me dërguarë kërkesën pas kabit 1 te kabi 2 unë nuk e di.Ka shkuarë kabi 1 i buxhetit të muajit tetor dhe brenda për brenda është rritur buxheti por janë ndryshuarë me vendim të Kuvendit të Republikës së Kosovës.Unë ju tregova që me 30 Qershor e kemi obligim me dërguarë por a votohet kjo kërkesë për 57 pozita për nivelin parafillor,ne e dërgojmë si kërkesë të bashkangjitur për kabin 1.

Halil Morina(anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):Faleminderit Kryesus.Unë shkurtë do të flasë për këtë qështje që jemi duke e diskutuarë tani.Ne e kemi kabin 1 dhe e kemi një kërkesë të drejtorisë së arsimit për rritjen e numrit të stafit të punëtorëve për tri çerdhet që nënkuptonë që duhet me u rritur buxheti dhe grandit për arsim,këto dyja ne nuk mundemi me i ndarë.Drejtorja e Arsimit në momentin që e ka paraqitur një kërkesë për tri çerdhet për 57

pozita pune,egzistonë një plane në bazë të cilit e caktonë edhe numrin e punëtorëve ne nuk kemi mundësi me rritur numrin e punëtorëve sepse ashtu është parashikuarë,prandaj edhe drejtorja e arsimit e ka paraqitur në këtë formë.

Prandaj unë nuk jam duke e parë asnjë arsyeje që ne mos me votuarë sot këtë kërkesë.Ne e dim që Kuvendi është pa parlamet dhe pa qeveri dhe ne nuk e dim a ka me u formuarë këtë vitë apo jo.Mirëpo ne duhet me bërë punën tonë të votojmë kabin 1 së bashku me kërkesën e arsimit dhe shpresojmë që kjo kërkesë e drejtorisë së arsimit e votuarë nga ne të bëhet pjesë e buxhetit,të funksionalizohen këto tri çerdhe që fëmijët tanë të kenë mundësi me shkuarë në çerdhe.Faleminderit.

Burim Paqarizi(anëtarë nga rradhët e Partisë Demokratike të Kosovës):Pjesërishtë faji ishte i Drejtorit për Ekonomi dhe Financa i cili nuk na prezantojë mirë numrin e punëtorëve që kërkohet dhe paraqiti një konfuzionë te kolegët sepse njëherë tha kërkohen 18 pozita pastaj 57 pozita. Drejtori nuk i lexojë tri faqe por vetëm një faqe dhe tani këtë qështje e kuptuanë të gjithë kolegët.Pra në kërkesën e drejtorisë së arsimit bëhet fjalë për 3 çerdhe që nevojitet 18 vende pune për secilën çerdhe që i bie afërsisht 57 pozita,kjo ka logjikë kurse ajo që e keni cekur drejtor për 18 pozita nuk kishe logjikë.Sa i përket grupit tonë parlamentarë ne jemi për me u funksionalizuarë këto çerdhe dhe secila shkollë të ketë kushte më të mira të punës,ne i mbështesim hapjen e çerdheve të reja,shpresojë që ato të hapen në afat sa më të shpejtë kohorë.Ne e votojmë për këtë pjesën pastaj mbetet në vazhdim se si do të shkojë kjo procedurë.Faleminderit.

Hafir Rexha(anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):Besojë që u shtjerën diskutimet për këtë qështje edhe pse unë e deklarova votën kundër sepse në fillim ishte e pakjartë,tani vota ime shkonë për.Por le të mbetet hera e fundit që ju e sjellin dokumentet në ditën e fundit,unë e kam parasyshë që ka mundësi me pasur ngecje dhe zvarritje nganjëherë por të paktën edhe neve me na sjellur nga një kopje.

Kryesues i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Nuk ka kërkesë të Drejtorisë së Arsimit rrjedhimishtë për shkak të procedurave sepse nesër MAPL-ja ta rëzonë ka fuzionim të kërkesës të Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave në këtë kontekstë ta gjykojmë.Se qfarë bëjnë drejtoritë në mes veti është qështje tjetër.

Blerim Thaçi(Drejtor për Ekonomi dhe Financa):Unë z.Hafir e kam marrë si obligim kërkesën e Drejtorisë së Arsimit sepse kjo kërkesë faktikishtë ju ka drejtuarë zyrës së Kryetarit dhe Kuvendit dhe e kemi dorëzuarë në Administratë.Kjo nuk është kërkesë e Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa,janë dy kërkesa që ju keni mundësi me i votuarë të ndara te kabin 1,dhe kërkesën tjetër ndarasë dhe pastaj i përcjellim të dyja në MAPL kjo është qështje e juaj mirëpo ne e kemi obligim me prezantuarë kërkesën.

Kryesues i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Unë mendoj që në këtë formë se si është duke u trajturë kemi me hasur në problemë.

Hafir Rexha(anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):Cila është duke mbetur në propozim kërkesa e Drejtorit apo e juaja?Na jepni një shpjegim.Cila do të mbetet?

Kryesues i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Jo unë nuk kam propozime.

Muharrem Morina(Zyrtar ligjor në Kuvendin Komunal):Faleminderit Kryesues.Përshëndetje anëtarë të Asamblesë,Drejtorë.Korniza afatmesme buxhetore është dokumentë strategjikë i komunës i cili llogaritet njëri ndër dokumentet më strategjike i cili është para pregaditje e buxhetit për vitin pasues.Korniza afatmesme buxhetore KAB-i 1 të cilën e quajnë ekonomistat.Në formën e cila ka ardhur nga Ministria e Financave ka ardhur e prerë që do me thënë kufijtë janë të prerë.Kërkesa e cila ka ardhur pas kësaj nëse e miratoni kërkesën e dytë prishet kabi 1 për shkak që nëse e ngrisim për 57 pozita pune atëherë ndryshonë edhe buxheti në tërësi i cili është i planifikuarë për paga,shërbime dhe mallëra.

Unë ju kisha sygjëruar kërkesa e cila ka ardhur e pregaditur nga Ministria e Financave për kabi 1 të votohet në formën e cila ka ardhur ky është kabi 1 është tavani kryesor që i vendoset komunës së Malishevës për mjetet që i ka në dispozicionë për me i shpërndarë për kategoritë buxhetore,pastaj e dyta është Drejtoria që i shpërndanë për kategoritë në bazë të kërkesave të drejtorive dhe projekteve për investime kapitale që i bënë Kryetari në bazë të buxhetit për vitin pasues.

Ndërsa kërkesa për rritjen e stafit është mirë me u votuarë,ndoshta do të ishte më mirë me dërguarë si kërkesë te Ministria e Financave.Do të ishte mirë me parë Ministria e Financave dhe Ministria e Arsimit plotësimin dhe ndryshimin e kornizës afatmesme buxhetore të komunës së Malishevës për kërkesën e rritjes së numrit të stafit në këtë rast për çerdhet.

Mirëpo në këtë rast ashtu siq ka ardhur kabi 1 nuk duhet me bërë kërkesa për shkak që e ndryshonë kompletë strukturën e kabit e cila është e punuarë prej Drejtorisë për Ekonomi dhe Financave dhe Ministria e Financave nuk kanë dëshirë me i ndryshuarë.

Kërkesa e Drejtorisë së Arsimit e cila është planifikuarë është e logjikshme mirëpo në aspektin ligjor nuk kalonë në këtë formë.

Drejtorja e Arsimit ka planifikuarë me rritur numrin e stafit të punëtorëve në çerdhe dhe me hapur me 1 shtator.Mirëpo kjo korniza afatmesme do të jetësohet në vitin 2027-të.Stafi mundet me u rritur në kuadër të buxhetit që e kemi për vitin 2026-të,ndërsa kabi 1 që e kemi në shqyrtim e sipër e kemi për vitin 2027-të.Kështu që kjo kërkesë nuk kryenë punë asgjë,nëse e votoni mundet MAPL-ja me na kthyer të jashtëligjshëm votimin.

Enver Hoti(anëtarë nga rradhët e partisë Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës):Faleminderit Kryesues.Ky është një dokumentë i rëndësishëm për zhvillimin e të ardhmës së Malishevës,z.Muharrem faleminderit për të gjitha interpretimet.Unë nga përvoja ime jam duke folur që mos e bëni kulaqin e madh këtu sepse atje në Kuvend ja u zvogëlojnë krejtë,ta keni parasyshtë këtë punë nuk e prishin ata atë rregullë.

Gjdo procedurë,gjdo kërkesë e komunës në qarkore buxhetore në këtë rast e cila ka të bëjë me rritjen e numrit të stafit për çerdhe,për funksionalizimin e çerdheve është e vërtetë që duhet me kaluarë nëpër filtra të tjerë siq është komisioni për buxhet parlamentarë e që ministria financion por nëse ne nuk kemi amandamentin atje dhe nëse ne nuk kemi atje propozime.Atëherë atje hallin tonë askush nuk e qanë.Nuk është e rëndësishme fare atje se qfarë thotë Ministria për kornizën afatmesme buxhetore dhe për propozimet e Kuvendit Komunal të Malishevës sepse ata e kanë punën e vetë dhe ne i kemi kërkesat e tona.

Prandaj Aleanca e mbështetë plotësishtë kërkesën e qeverisjes komunale për me rritur numrin e stafit, me i funksionalizuarë çerdhet, mënyrën se si i siguronë mjetet Ministria e Financave është qështje e saj, nëse dëshirojnë me na penalizuarë munden edhe pse ata na kanë penalizuarë shumë herë, prandaj kjo nuk është shumë e rëndësishme për neve këtu as për Drejtorin e Ekonomisë dhe as për zyrtarin e komunës dhe as për Drejtorin e Arsimit, më falni unë nuk e di kush e ka paraqitur kërkesën te drejtoria e arsimit mirëpo aty ka nevojë me u rritur numri i stafit dhe komuna nuk ka buxhet për me mbajtur të mirëfilltë procesin që duhet me u mbajtur në ato çerdhe. Kuvendi i Republikës së Kosovës ka mjete të mjaftueshme dhe ato mjete i shpërndanë si dëshironë për shembull i ndanë për organizata të ndryshme jo qeveritare e lëre më për nevojat e tona që janë për fëmijët tanë që janë të domosdoshme.

Nga përvoja ime institucionale jam duke folur se ashtu si e dërgonë kulaqin atje ata kanë me ta zvogëluarë më shumë, ne i dim edhe ato rotacionet që janë në qeverisjen komunale dhe nuk janë të mira në funksion të komunës dhe as të qytetarëve tanë. Unë nesër me pasur mundësi ja'u marrë pushtetin por në vendin tim do të luftojë që të ketë investime dhe ju mos e keni dertë se si ata e trajtojnë kornizën afatmesme buxhetore si Ministri e Financave që janë ata atje. Ata i kanë punët e veta dhe ne i kemi punët tona këtu nuk ka asgjë të jashtëligjshme.

Këtu egzistonë nevoja që ne të kemi të punësuarë më shumë dhe ajo duhet me hyrë në ligj në Ministrinë e Financave. Kjo është kërkesë e arsyeshme dhe unë do ta mbështesë deri në fund. Faleminderit.

Kryesues i Kuvendit z. Fatmir Ademaj: Faleminderit z. Enver Hoti, i nderuar z. Enver Hoti ju ishit jashtë sallës kur ne e diskutuamë shumë këtë qështje dhe ne jemi për me kaluarë por vetëm duhet me gjetur procedurën ligjore që me kaluarë, ju nuk ishit prezentë kur u diskutua dhe nuk ka pasur tendencë nga asnjë grup parlamentarë që mos me kaluarë kjo pikë. Ju Asambleistë të cilët jeni duke dalur jashtë dhe pasi që po ktheheni në sallë jeni duke menduarë që nuk është duke ndodhur asgjë në sallë, jeni duke i folur disa fjalë që ajo temë është diskutuarë shumë gjatë.

Enver Hoti (anëtarë nga rradhët e partisë Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës): Unë nuk nvaresh nga diskutimet e askujt, unë nuk jam kopje ta keni parasyshë. Unë e paraqesë qëndrimin tim 100% edhe në qoftëse është me ty, unë nuk e diskutova që ju nuk keni të drejtë por këtu jam njejtë sikur ju me vullnetin e qytetarëve dhe unë shprehem sipas asaj që unë mendojë se duhet me u shprehur. Prandaj nuk keni nevojë me replikuarë në këtë formë.

Unë do ta mbështesë mënyrën dhe procedurën që janë të karta dhe ligjore që janë egzistente, meqenëse egzistonë çerdhja dhe ka nevoja që me pasur rritje të stafit duhet me përmbushur, kërkesa është ligjore dhe duhet me gjetur mënyrën. Faleminderit.

Kryesues i Kuvendit z. Fatmir Ademaj: Faleminderit z. Enver Hoti kjo që e the ishte e saktë. Të gjithë e kemi të njejtin qëndrim se si me gjetur formën ligjore. Fjalën ja kalojë Drejtoreshës për Arsim dhe Edukim znj. Arbëreshë Krasniqi. Urdhëro.

Arbëreshë Krasniqi (Drejtoreshë për Arsim dhe Edukim): Përshëndetje për të gjithë! I nderuar Kryesues i Kuvendit, Drejtor të pranishëm, të nderuar Asambleistë të Kuvendit Komunal të Malishevës. Ne si Drejtori e Arsimit kemi konsideratë për diskutimin që ju e kishit po ashtu edhe

të z.Muharremit gjithashtu duke e vlerësuarë maksimalishtë qëndrimin e diskutimit të z.Hotit,më vjen keq që nuk isha prezentë fizikishtë që ti dëgjojë diskutimet edhe të tjerëve,por jam e bindur që secili prej juve dëshironë të funksionalizohenë çerdhet në Komunën e Malishevës.

Të nderuar Asambleistë unë para se me filluar me diskutimin për me shpejguarë saktë këtë qështje kërkesën që ka ardhur nga Drejtoria e Arsimit,sigurishtë që dihet që çerdhet në Malishevë këto tri të fundit janë si rezultat i bashkëpunimit të Ministrisë së Arsimit në nivel të Republikës së Kosovës dhe sigurishtë që objektivishtë këto çerdhe janë mundësuarë nga investimi i nivelit qëndrorë për këtë pjesë unë jam falenderuese atyre,kemi pasur një bashkëpunim pothuajse të shkëlqyeshëm në mes të Drejtorisë së Arsimit dhe Ministrisë së Arsimit për katër vitet e kaluara.

Unë shpresojë dhe besoj shumë që do të vazhdojmë me të gjithë njëjtë me këtë bashkëpunim duke mos haruarë që në situata të tjera e pretë bashkëpunimin e shkëlqyerë në kuadër të mundësisë investive objektive të çerdheve në Komunën e Malishevës e kur ndalemi te qështjet e tjera të gjithë e dini sikurse edhe unë që nuk kemi pasur ndonjë bashkëpunim tjetër edhe pse kemi pasur nevoja të shumëta e krahasur me kërkesa dhe ne ju kemi drejtuarë Ministrisë që të na ndihmojnë edhe për objektet e tjera shkollore në Komunën e Malishevës.

Të nderuar të pranishëm në fjalimin që e tha Asambleisiti z.Enver Hoti është plotësishtë e saktë dhe z.Enveri e din shumë më mirë ndoshta se sa të tjerë që jeni këtu,por nuk do të thotë që këtë pjesën procedurale nuk e dinë dhe nuk e kuptojnë edhe të tjerët,z.Hoti e tha saktë që nëse kërkohet 57 numri fizik që të funksionalizohet procesi në tri çerdhet në Komunën e Malishevës atje nuk kalonë ajo që kërkohet prej neve,atje në Ministri mundohen me minimizuarë për shkakë sigurishtë të arsyeve të tjera por një ndër to dëshirojë me vlerësuarë që është për shkak që kanë kërkesa edhe komunat e tjera njëkohësishtë në drejtim të Komisionit për Buxhet dhe Financa njëkohësishtë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Por e jona duhe me qenë kjo edhe për kundër insistimit të më shumë se dhjetë emailave zyrtare dhe të kontakteve zyrtarishtë dhe fizikishtë në Ministrinë e Arsimit të kërkesave tona të cilat janë në dokumente zyrtare nuk kemi pasur një reflektim pozitive as nga Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe njëkohësishtë as nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave duke e përfshirë këtu pothuajse edhe të Ministrisë së Arsimit.

Prandaj kemi ardhur në këtë pikë do të duhej të gjithë sipas rregullave që kemi shkuarë me kërkesat tona me buxhet për ekonomi dhe financa në Ministrinë e Ekonomisë gjithashtu duke prirë me kërkesë në Ministrinë e Arsimit gjithmonë na'u është pranuarë numri fizikë për funksionalizimin qoftë për çerdhën që e kemi pasur një aneksë në Malishevë gjithashtu edhe çerdhën në Kijevë.Kësaj rradhe nuk ka reflektuarë kjo dhe për mua është e pakuptimtë pse investohet objektivishtë në çerdhet e Komunës së Malishevës por nuk ju lejohet mundësia e funksionalizimit me numër fizik të punëtorëve që të punojnë në ato çerdhe.

Të nderuar të pranishëm duhet me pasur parasyshë që Komuna e Malishevës ka shumë kërkesa për fëmijë që të akomodohenë në çerdhe kjo është një e vërtetë shumë e madhe,kemi pothuajse një mbi ngarkesë në çerdhën e Malishevës e duke mos e anashkaluarë edhe çerdhën në Kijevë,prandaj unë konsiderojë që ky dokumentë para se gjithash është një sensibilizim i Kuvendit Komunal të Malishevës që do ta forconë kërkesën tonë në mundësinë e lirimit të numrit të ri fizikë për tri

çerdhet në Komunën e Malishevës, z. Muharrem ndryshe nuk kalohet unë jam e bindur sepse e di mirë atë situatë atje.

Prandaj na duhet mbështetja për këta numra të ri fizik. Dëshirojë me ndarë një informacione me juve që ta keni të kjashtë, në vitin 2024-të i kemi 1016 puntorë në sektorin e arsimit e në vitin 2027-të është planifikuar nga drejtori për ekonomi dhe financa edhe pesë numra fizik të ri në lëvizje gjë që e pa mundëson funksionalizimin e çerdheve dhe kjo nuk i jep mundësi që ndonjë numër tjetër që e kemi aktualë fizik ose të ndonjë punonjësi që të rifunksionalizohet në çerdhet në të cilat po kërkohet funksioni i tyre sepse nuk ka mundësi mësuesin e klasës që e jep lëndën për fizik ose matematikë ta dërgojmë në çerdhe dhe të punojë si edukatorë. Prandaj numri fizik i lejuarë i kërkuar nga ne duhet me qenë i profilit adekuat që i shërben funksionalizimit të çerdheve në Komunën e Malishevës.

Kjo është kërkesa jonë i nderuar Kryesus dhe nëse keni diqka pyetje unë do të ju jap informacione, por të gjitha në praim janë ato që përbëjnë njëkohësisht një mbështetje për këtë kërkesë që ka ardhur nga Drejtoria e Arsimit, mos e haroni edhe njëherë unë nuk kam pasur rastin që me ja dorëzuar kërkesën drejtorit për ekonomi dhe financa por ky e din mirë sepse vjen po nga një eksperiencë e punës si drejtorë i arsimit e din mirë që Komuna e Malishevës është ballafaquar me pengesat të tilla.

Unë në këtë rast konsideroj që do ti bëjë nder Drejtorisë së Arsimit dhe njëkohësisht do ti bëjë nder funksionalizimit të tri çerdheve nëse aprovohet kërkesa jonë që ne të vazhdojmë më fuqishëm me kërkesa në drejtim prapë edhe të Komisionit për Buxhet dhe Financa, njëkohësisht në Ministrinë e Arsimit, gjithashtu edhe në Ministrinë e Ekonomisë. Faleminderit Kryesus.

Kryesus i Kuvendit z. Fatmir Ademaj: Faleminderit znj. Arbëreshë Krasniqi. Fjalën e ka kërkuar z. Muharrem Morina. Urdhëro.

Muharrem Morina (Zyrtar ligjor në Kuvendin Komunal): E nderuar Drejtoreshë mendoj se keni keqkuptuar sepse unë nuk thash që nuk është e nevojshme rritja e këtij stafi angazhimi i këtij stafi përmes procedurave ligjore. Dokumenti kornizë afatmesme buxhetore është dokument i cili pregaditet sipas financave publike nga Ministria e Financave, në kornizat afatmesme ata e prejnë buxhetin dhe në mesin e tyre është edhe komuna jonë. Unë nuk isha kundër kërkesës së Drejtorisë së Arsimit por e thashë nëse inkorporohet kërkesa e drejtorisë në këtë kornizë atëherë ndryshohet korniza. Nëse shtohet si kërkesë e votuarë drejtë për drejtë kërkesa e drejtorisë së arsimit është diqka tjetër, unë e thashë që nëse inkorporohet në kornizë afatmesme atëherë kufijtë buxhetor ndryshojnë sepse rritet stafi, rritet kostoja. Unë e pata qëllimin me ju shpjeguar se nëse futet kjo kërkesë në këtë projektë draftë atëherë ndryshonë kompletë struktura e kornizës afatmesme buxhetor.

Enver Hoti (anëtarë nga rradhët e partisë Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës): Ne jemi në Kuvend edhe në Kuvend jam për me i trajtuar qështjet, nuk kemi në Gjykatë. Jemi në fazën e projektionit që jemi duke ndërtuar projekte që janë në interes për qytetarët e komunës tonë. Ne jemi duke i propozuar sepse vetë këto nuk mundemi me i realizuar por në bashkëpunim me institucionet qëndrore prandaj nuk jemi duke folur për ligj por për projekt ligj. Cila është logjika që tha Drejtoresha që ka korendu me investimin e qeverisë qëndrore? Qeverisa qëndrore do ta

kishte për obligim që kur i ka ndarë investimet me i ndarë edhe numrin e stafit për personel,kjo nuk do të duhej me qenë fare temë e jona.

Ne jemi duke folur për projektion kurse anën ligjore se ku i gjenë mjetet Ministria është punë e tyre sepse prej komunave ka kërkesa jo vetëm për rritjen e numrit për personel por paraqesin kërkesa që ndoshta duken edhe banale.Ju nuk keni nevojë të brengoseni ata e gjenë mënyrën vetë si me realizuarë.Ne jemi duke folur për projektione dhe për projektet buxhet ende nuk është ligj as korniza nuk është ende ligjore por është shqyrtim dhe trajtim.Faleminderit.

Halil Morina(anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):Unë një gjë nuk jam duke e kuptuarë,këtë kornizë e ka prerë Ministria e Financave dhe i ka vendosur kufijtë.Ne nuk kemi të drejtë me i ndryshuarë kufijtë sot,ky është problemi,sikur të kishim ne të drejtë këtu që buxheti prej njëzetë e dy million euro për vitin 2027-të dhe pastaj ne si Kuvend këtu së bashku me Kryetarin e Komunës ne do të kishim mundësi me i ndarë vetë si dëshirojmë për shembullë sa dëshirojmë me i ndarë në paga dhe mëditje dhe ne pastaj me i shtuarë në paga dhe mëditje.

Ne nuk kemi mundësi me e bërë këtë punë,në momentin që ne nuk kemi mundësi me bërë këtë punë,ne nuk kemi mundësi me inkorporuarë në korniza afatmesme buxhetore kërkesën e drejtorisë së arsimit sepse ka me na kthyer mbrapa,sepse kufijtë i kemi tejkaluarë dhe ne nuk kemi të drejtë dhe nuk ka kompetencë ky Kuvend me i tejkaluarë kufijtë që i ka vendosur Ministria e Financave. Kam një pyetje shkurtë për Drejtoreshën e Arsimit: kjo kërkesë a po synohet që me 1 shtator të këtij viti me filluar çerdhet,apo për më vonë?

Këtë kërkesë a po synojmë ne që me miratuarë dhe në muajin shtator me pasur stafin e gatshëm?Ju duhet me na shpjeguarë mire këto gjëra jo me ardhur para Kuvendit dhe me na thënë ju votoni si të dëshironi,sepse kjo nuk qështje e jona.Ju duhet me shikuarë anën ligjore si ekzekutiv dhe pastaj me na treguarë neve se kjo është në harmoni me ligjin ose me na thënë votone kërkesën e arsimit si pikë e veçantë e rendit të ditës kërkesën e drejtorisë së arsimit për rritjen e numrit të stafit në arsim për tri çerdhe prej numrit fizik 57 për pozita të ndryshme pune.

Ne e votojmë si kërkesë të veçantë,kjo votohet në Kuvend pastaj u shkonë Komisionit Parlamentarë për buxhet,pastaj mundet me u propozuarë në Kuvend dhe pasi të votohet mundet me u bërë pjesë e Kornizën buxhetore.Ne nuk kemi mundësi me bërë vetë pjesë të Kornizës buxhetore.Për mua është fakt absurd që një qështje kaq të rëndësishme jeni konfuzë edhe ne nuk dëshirojmë me ju parë më konfuzë në kërkesat e juaja.

Ju e keni sjellur një kërkesë tek ne dhe nuk jeni duke ditur me na treguarë se si duhet me votuarë ne kjo është absurdre dhe e pakuptim.

Arbëreshë Krasniqi(Drejtoreshë për Arsim dhe Edukim):Nuk ka këtu konfuzitet.Ne e pohuamë kjo,është Drejtoria për Ekonomi dhe Financa që mundet me na lejuarë në këtë rast një ndryshim të një tavani buxhetor që e ka parashikuarë Ministria e Arsimit në drejtim të komunës së Malishevës.

Unë e thashë si kërkesë e cila ka ardhur prej Drejtorisë së Arsimit ka ardhur si rezultat i shumë kërkesave tona në drejtim të këtyre tri mundësive,Komisionit për buxhet dhe financa,Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Arsimit neve nuk na kanë lejuarë,z.Blerim Thaçi e din se si lejohenë numrat fizik e duhet me ditur edhe ju secili.

Numri fizik i ri nuk mundet me u planifikuarë me këtë buxhet Komuna e Malishevës sepse nuk i ka krijuarë mundësi. Ju e planifikoni kur ai ju lejonë për shembull siq ka ndodhur në çerdhen e Malishevës në Kijevë na ka lejuarë 22 numra të ri fizik është detyruar Drejtori z.Blerimi me i paraparë në buxhet, ai le ti merrë ku të dëshironë në momentin kur për numrin fizik ti lejonë këto tri mundësi që kalonë atje z.Blerimi me patjetër do ti ketë këtu.

Ne jemi duke e bërë këtë planifikim për këtë numër ti ri fizik në kuadër të asaj pjese të Kab-it që e ka sjellur z.Blerimi besoj që edhe ju jeni duke e ditur këtë pjesë.

Ne jemi duke kërkuarë që kjo kërkesë të votohet e veqantë dhe ti shkonë Komisionit për buxhet dhe financa, pastaj në Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Arsimit dhe të senzibilizohet kërkesa e Drejtorisë së Arsimit që ju kemi dërguarë emaila të shumta por nuk na kanë përfillurë dhe ne në një formë të dima secili prej neve këtu e secili grup parlamentarë politikë që nuk e kemi mbështetjen për këto objekte që janë ndërtuarë në komunën e Malishevës dhe pastaj nesër ata mos të na thojnë që ne nuk kemi bërë kërkesë.

Ne e kemi bërë kërkesën mirëpo nuk po na lejojnë numrin e ri fizik, nuk ka mundësi me u funksionalizuarë asnjë objektë i cili ndërtohet e që vlera e këtyre tri objekteve e kalonë vlerë e një million e gjysmë euro kanë me mbetur si objekte investive, e din disa Asambleistë që janë dërguarë paisjet teknike të kuzhinave dhe një ditë ato ka me i kapur korizioni nëse nuk ka lejohet numri i ri fizik.

Prandaj kjo kërkesë ka ardhur në këtë formë, nuk e pengonë planifikimin e Kab-it që e ka bërë z.Blerimi, kjo është një kërkesë e veqantë. Unë edhe një herë po ju kërkojë falje që nuk isha prezentë nga fillimi, përndryshe kjo kërkesë është e veqantë dhe unë po ju kërkojë mirëkuptimin tuaj, nuk ka konfuzitet, këtu ka një senzibilizim me vote që neve do të na mundësonë që atje të operojmë dhe të vazhdojmë më tutje që me na lejuarë numrin e ri fizik.

Kryesues i Kuvendit z.Fatmir Ademaj: Para se me vazhduarë me diskutime, a e kalojna kërkesën e arsimit për trajtim te pika të ndryshme? Në rendin e ditës jemi te pika e tretë e KAB-it.

Halil Morina (anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate): Ne përsëri erdhëm te ajo pika që këto dyja nuk shkojnë bashkë. Meqenëse këto dyja nuk shkojnë bashkë ne e votojmë KAB-in, pastaj kërkesën tjetër nëvaret nëse ka inplikime financiare.

A është dashur fillimisht me me u trajtuarë në KPF? Sepse nesër nuk dëshirojmë që MAPL-ja me na kthyer me na thënë nuk ka inplikime financiare sepse ju fillimisht nuk e keni trajtuarë në KPF. Fillimisht ta votojmë KAB-in.

Veton Zogaj (anëtarë nga rradhët e partisë Lëvizja Vetëvendosje): Fjalimin që e tha z.Halil edhe unë njejtë dëshirova me thënë. Dy kërkesa nuk kemi mundësi me i trajtuarë bashkë pavarësisht që ne dëshirojmë, sepse kërkesën e Drejtorisë së Arsimit nuk e kemi pasur sot në rendin e ditës. Askush nuk është kundër që me votuar kërkesën e Drejtorisë së Arsimit mirëpo sot nuk kemi mundësi me i trajtuarë së bashku me kërkesën e Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa sepse nuk e lejonë ligji.

Sot është thirrur seancë e jashtëzakonshme dhe nuk ka mundësi me trajtuarë kërkesën e Drejtorisë së Arsimit në rendin e ditës, sikur se që bëni në seancat e rregullta që propozoni kërkesa të reja jashtë rendit të ditës, plus e shtojmë faktin që e përmendi z.Halili që ka inplikime financiare dhe që këtë kërkesë duhet me trajtuarë fillimisht në Komitetin për Politikë dhe Financa.

Nëse nuk i hup koha kësaj kërkesë e thërrisni së pari një mbledhje në KPF e trajtojmë atje, pastaj e thërrisni prapë mbledhje të jashtëzakonshme në Kuvend dhe ne e votojmë kërkesën e Drejtorisë së Arsimit për arsyeje që mos të bëjmë shkelje ligjore kur e dimë me vetëdije të plotë që nuk bënë.

Hafir Rexha(anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):Në bazë të gjithë atyre që e diskutuanë rreth një orë,nuk keni thenë asgjë.Secili keni pohuarë se jeni pro kësaj kërkesë,të gjithë jemi pro kësaj kërkesë,mirëpo kjo kërkesë nuk ka hyrë në rendin e ditës fare,ne jemi duke diskutuarë diqka që ne nuk e kemi në rendin e ditës kurse ne jemi duke folur këtu se a mundemi me kaluarë apo jo.Në bazë të atyre diskutimeve që u thanë unë i bashkangjitem parafolësve që kjo kërkesë të trajtohet në mënyrë të veçantë,fillimishtë le të trajtohet në KPF dhe ne ti kryejmë punët tona si Asambleistë.Faleminderit shumë.

Enver Hoti(anëtarë nga rradhët e partisë Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës):Jam duke u befasuarë pak me qëndrimet e kolegëve,thujse jemi duke bërë ndonjë shkelje të madhe ligjore.Unë mendoj që nuk jemi duke e shkelur ligjin,ne jemi duke folur për një kornizë në të cilën do të mbështet buxheti për vitin 2027 i komunës së Malishevës.Nëse këto qarkore buxhetore z.Muharremi e din mirë që ka qenë qarkorja e parë, e dytë dhe e treta nuk e kanë rolin për me marrë informacionin dhe kërkesat,organizata buxhetore për me i planifikuarë që nesër mos me qenë në listë buxhetore.atëherë ne kotë jemi duke diskutuarë këtu.

Atëherë nëse ata e prejnë buxhetin pa asnjë interesë pa asnjë rol,atëherë krejtë kjo qeverisje komunale kotë e ka diskutuarë këtë.Ne nuk jemi duke e legjur ligjin,as projekt ligjin,as ligjin e financave nëse ne e dërgojmë atje një kërkesë për shtimin e stafit,sepse kjo është dashur me u planifikuarë atëherë por nuk e kanë planifikuarë fare,pastaj ka me rezultuarë tjetra që jam duke ju para lajmëruar juve Krysus dhe ju të tjerëve që jeni këtu,nesër ka me ju thënë ju nuk e keni para parë në projekt buxhet në kornizën afatmesme,pastaj ju do të vazhdoni me kërkesa nëpër korridore atje.Më falni por keni me pësuar ju dhe ne si qytetarë.

Prandaj ne jemi në fazën e planifikimit,buxheti i Republikës së Kosovës,korniza afatmesme e Republikës së Kosovës përfshinë edhe komunën e Malishevës në bazë të planifikimit.Ne nuk jemi duke vendosur por jemi duke e planifikuarë që me u përfshirë,nuk jemi ne që jemi duke e shkelur ligjin.Kjo është kërkesë e arsyeshme,legjitime dhe e domosdoshme.

Blerim Thaçi(Drejtor për Ekonomi dhe Financa):Unë në fillim kur e prezantova kërkesën para juve ju tregova që kjo është kërkesë shtesë që ju ka drejtuarë zyrës së Kryetarit dhe Kuvendit të Asamblesë,kjo kërkesë kalonë vetëm në Kuvend të Republikës së Kosovës.

Ne si kornizë e KAB-it nuk shkonë në Kuvend,departamenti i buxhetit e refuzonë këtë rritje të KAB-i 2 kur të vie planifikimi i buxhetit që votohet në muajin shtator,juve nuk ju lejonë me planifikuarë sepse stafi është i përcaktuarë me numër të nxënësve dhe ju e vërejtët që është minus 76,000.00€ grandi i stafit të arsimit është më i ulët,për këtë arsyeje është mirë me shkuarë kjo kërkesë si shtesë.

Ne ju drejtojmë departamentit të buxhetit por edhe komisionit për ekonomi dhe financa në Kuvend dhe Ministrisë së Arsimit që me kaluarë në Kuvend sepse sa i përket KAB-it 1 dhe KAB-it 2 ne e dim që ka me u refuzuarë.Departamenti i buxhetit na refuzonë.

Bashkim Krasniqi(anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):Ne fillimishtë e votuam një rend të ditës,edhe pse unë e kam të kuartë të që kërkesa e Drejtorisë së Arsimit është e veçantë dhe nuk është në kuadër të KAB-it.Nëse ju e keni thirrur një mbledhje të jashtëzakonshme dhe nuk e keni në rendin e ditës,ne mundemi me diskutuarë shumë tema,por për derisa nuk e kemi në rendin e ditës atëherë cili është kuptimi që do ta votoni.Secili prej neve e kemi qëllim që kur të votohet diqka do me thënë ajo me u aprovuarë edhe në instanca të tjera që ajo të jetësohet.Sot është data 12 dhe besoj që gjatë këtij muaji kemi mundësi me mbajtur edhe një mbledhje tjetër që me qenë më konkrete dhe me vendosur në rendin e ditës fillimishtë në KPF,ne sot i patëm katër pika të rendit të ditës dhe nuk ishte kjo kërkesë e Drejtorisë së Arsimit.

Nëse nuk është kërkesa në kuadër të KAB-it,ajo kërkesë nuk është në rendin e ditës atëherë jeni duke votuar diqka që nuk është në rendin e ditës.Pse me bërë ne një veprim i cili nuk është në rregull?Kjo është qështja e cila është mirë me u shpjeguarë.Pse ne jemi duke e diskutuarë këtë pikë në rendin e ditës?

Burim Paqarizi(anëtarë nga rradhët e Partisë Demokratike të Kosovës): Ndoshta në fillim është gabimi i Drejtorit për Ekonomi dhe Financa që nuk e bëri mirë prezantimin.Ne u pajtuam të gjithë që me u funksionalizuarë çerdhet,Drejtoresha e Arsimit u vonua dhe ne kemi bërë debat që një orë pa kuptim.Kjo është logjika dhe mënyra që ne jemi duke diskutuarë për këtë kërkesë sepse askush nuk është kundër asaj kërkesë dhe besoj që ne duhet me rritur intenzitetin me presionin më të madh ndaj qeverisë.

Ne duhet me gjetur formën e duhur dhe pajtohem me mendimin e z.Bashkim Krasniqit nëse ne nuk e kemi në rendin e ditës dhe nëse nuk është në formën legjitime mos ta bëjmë fare.Nëse e kemi një mundësi për me votuar atëherë ne të gjithë jemi për me mbështetur.Le të shpejgohet dhe mos të ipen shumë mendime të ndryshme sepse secili prej përfaqësuesë tanë jemi duke dhënë nga një mendim dhe në fund nuk jemi duke e vendosur a me hedhur në votim apo jo.Jemi duke e diskutuarë që një orë dhe nuk jemi duke e përcaktuarë si me vazhduarë më tutje.

Le të ipet një mendim dhe formë më e mirë e mundshme për me votuarë nëse është ligjërishhtë e lejuarë.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Që nga fillimi trajtimin e kemi bërë për Kornizën afatmesme,ky diskutim ka qenë,kërkesa a me hyrë në kornizë dhe jo jashtë rendit të ditës.Në momentin që diskutohet për kërkesë të re ashtu siq është duke e pohuarë Drejtoresha e Arsimit,kalonë në nivel tjetër dhe ne nuk e diskutojmë.

Halil Morina(anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):Kur të përfundonë kjo seancë e thërrisni një seancë tjetër vetëm për këtë pike dhe e vetojmë.Qëllimi jonë është që le të na jep dikush garancion që kjo punë e jona nuk bie ndesh me ligjin dhe nuk na kthejnë mbrapa MAPL-ja atëherë ne e votojmë tani.Mirëpo unë nuk dëshirojë me votuarë diqka tani që na merrë kohë një muaj derisa të kthehet nga MAPL-ja sepse ne nuk kemi mundësi me trajtuarë edhe njëherë,vetëm qka jemi duke i humbur kohë vetës,e që ne kemi mundësi për shembull me kryerë nesër.

Nesër thirrreni një seancë të KPF-së pastaj në mes dite thirrreni të Kuvendit vetëm për këtë qështje sepse kjo është qështje e rëndësishme me u shtuarë stafi.

Nëse kërkesa e Drejtorisë së Arsimit nuk është në rendin e ditës kam frikën që ka me kthyer mbrapa meqenëse dikush nga nalt përpiqet me na penguarë menxi ska me pritur me gjetur ndonjë vegëz që me ta hudhur poshtë kërkesën.

Arbëreshë Krasniqi(Drejtoreshë për Arsim dhe Edukim):I nderuar Kryesues,të nderuar Asambleistë,kjo kërkesë kam dëshirë të votohet si e veçantë nga KAB-i.Unë kam pasur mendim që ti drejtohem secilit Asambleistë të Kuvendit Komunal të Malishevës me kërkesë të Drejtorisë së Arsimit me emrin dhe mbiemrin e secilit që të vazhdohet presioni e të na lejohet numri fizik.Unë mendoj Kryesues,Drejtor,z.Muharrem dhe ju që e drejtoni këtë seancë mendoj që e dini,por ka edhe na ju që keni përvojë dhe e dini këtë pjesë që nuk është asnjë penalizim që me u futur si pikë e veçantë kjo kërkesë e Drejtorisë së Arsimit,asgjë nuk e pengonë KAB-in.

Mos u lodhni se qfarë trajtimi dhe përgjigjije na kthen MAPL-ja edhe mos u befasoni sepse ashtu kanë vazhduarë me i kthyer përgjigjet,mos u befasoni asnjëherë.

Jemi ballafaquarë ashpër me numri e ri fizik që i kemi kërkuarë 22 për çerdhen në Kijevë dhe Malishevë.Ju kam treguarë në Asamble nëse nuk e haroni kemi pasur ballafaqime me emaila zyrtare edhe në kontaktë fizik me Ministrinë e Arsimit dhe me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave me mbi njëqind probleme na kanë lejuarë 22 numrin fizik të punëtorëve.

Atë mos e haroni vjedhurazi e din z.Blerimi e kanë inkorporuarë edhe çerdhen e Banjës.A e dini ju?Kërkesa ka qenë Aneksi 1 çerdhja në Malishevë dhe çerdhja në Kijevë.

Kur kanë filluarë ata ndërtimin dhe planifikimin që e kemi bërë kërkesën ne për çerdhën në Banjë,në një formë tani ata po dëshirojnë me justifikuarë një përgjigje që e kemi bërë atë numër fizik për këto dy çerdhe aktuale që janë duke thënë e kemi përfshirë pak a shumë edhe numrin fizik për Banjë.

Prandaj jam duke ju thënë edhe njëherë këtë shqetësim që unë vazhdoj me pasur për qështjen e funksionalizimin e tri çerdheve por megjithatë Kryesuesi e din e do të dëshiroja me ditur që nuk është asnjë shkelje ligjore me u votuarë si kërkesë e veçantë brenda kësaj sance të jashtëzakonshme asgjë nuk e penalizonë dhe mos u lodhni fare se qfarë përgjigjije na kthenë MAPL-ja .

Unë dëshiroj senzibilimin si grupe politike parlamentare këtu në Kuvendin Komunal të Malishevës që të jemi një zëri bashkë në numrin e ri fizik.Nuk na pengonë asgjë sepse ka me u bërë rishikimi i buxhetit dhe ju e dini kur bëhet në Kuvendin Komunal.

Kjo kërkesë e jona e votuarë dhe e mbështetur në Kuvendin Komunal të Malishevës e ka një fuqizim shtesë si kërkesë në Komisionin për Buxhet dhe Financa,z.Hoti e din e merrë një tjetër legjitimitet sepse nuk është më këtu vetëm Drejtoria e Arsimit sepse janë sensibilizuarë me vote pro të gjitha grupet politike në Komunën e Malishevës dhe po kërkojnë jetësimin e tri objekteve të çerdheve që i ka ndërtuarë vetë Ministria e Arsimit me kërkesën e Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Malishevës.

Kjo nuk është shkelje ligjore për këtë pjesë e di saktë e Kryesuesi duhet me ditur edhe më mirë,kjo është kërkesë e veçantë dhe kjo është dashur me hyrë si kërkesë e veçantë sepse edhe z.Blerimi e din që Drejtoria e Arsimit nuk mundet me interferuarë me numrin e ri fizik,nuk besoj që është e nevojshme që me kaluarë në Komitetin për Politikë dhe Financa por vetëm ju nëse e konsideroni të arsyeshme.Asambleisti z.Enver Hoti e shpjegojë në mënyrën më të mirë të mundshme.

Ne jemi mësuarë si Malishevë me na mbetur kërkesat atje rrugëve dhe mos me i marrë askush parasyshtë.

Mos e haroni këtë pjesë nuk e kemi pasur anjë zë tonin atje për katër vitet e fundit ka munguarë mbështetja dhe ne e dim se si jemi ballafaquarë dhe si jemi duke u ballafaquarë me mungesa të shumta në 37 objekte shkollore që i ka komuna e Malishevës, kemi mungesa imediate nëpër shkolla dhe ne si Drejtori e Arsimit ballafaqohemi për ditë me këtë dhe ata asnjëherë për kundër kërkesave që i kemi paraqitur nuk kanë qenë në gjendje me na mbështetur. Na kanë mbështetur në kërkesa për çerdhe e ju e dini si na kanë mbështetur, ka qenë vazhdimësi e kërkesave tona edhe deri në momentin e fundit z. Hoti kanë kërkuarë edhe numrin e fëmijëve kur kanë lindur prej vitit 2021 deri në vitin 2023 dhe është dashur me shkuarë te zyra e gjendjes civile me marrë numrin e e personave që me ja u arsyetuarë kërkesën që na kanë bërë për çerdhet.

Unë jam duke e thënë edhe një herë nëse jeni të gatshëm e procedojmë në Komitetin për Politikë dhe Financa sepse dëshiroj me ju kërkuarë falje që u vonova për shpjegim dhe ky debatë ka zgjatur shumë, por z. Blerim është dashur me ditur sepse kjo kërkesë nuk shkonë si dokumentë i përbashkët me KAB-in sepse nuk kemi mundësi me bërë atë veprim.

Por nëse jeni të pajtimit e thirrni takimin e Komitetit për Politikë dhe Financa e kaloni në KPF, pastaj kaloni në Kuvendin Komunal si kërkesë dhe mendoj që kjo kërkesa e aporovuar në Kuvendin Komunal na ndihmonë neve si Drejtori edhe dalim mirë si Komunë e Malishevës përballë kërkesave që i kemi të nevojshme për funksionalizimin e këtyre tri objekteve të çerdheve në Komunën e Malishevës.

Kryesues i Kuvendit z. Fatmir Ademaj: Faleminderit znj. Arbereshë Krasniqi nuk besoj që ka nevojë për sqarim nga Asambleistët komunal. Sa i përket thirrjes së seancës dhe mbarë vajtjes janë i përgjegjshëm. Thirrja e seancës së jashtëzakonshme, thirret tri ditë pune para mbledhjes dhe realisht ky ka qenë rekomandimi i MAPL-së që nuk e kemi mbajtur mbledhjen e rregulltë por të jashtëzakonshme. Ndërsa te pika e katër e rendit të ditës thuhet se për mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit nuk mundet të plotësohet e as të ndryshohet.

Kjo ka mundur të trajtohet te pika të ndryshme si kërkesë e një Asambleisti dhe kursesi e Drejtorit për shkak që nuk ka kërkesa nga ekzekutivi asnjëherë proceduralishtë apo diqka tjetër por vetëm si kërkesa të Kryetarit munden me hyrë në rendin e ditës nga Kryesuesi i Kuvendit.

Kështu që ne vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës. Nëse nuk ka dikush diqka me shtuarë për KAB-in e hedhim në votim propozimin e Drejtorit për Ekonomi dhe Financa? Kush është për?

Rezulati i votimit: 22 për, 0 kundër, 1 abstenim.

Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me shumicën e votave për nga Kuvendi Komunal u miratua Korniza afatmesme buxhetore për vitin 2027-2029 me theks të veçantë për vitin 2027-të.

Pika 4

Pika e katër e rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 01/869 dt. 08.06.2026 e parashtruar nga Kryetari i Komunës për funksionin e Organit të Kujdestarisë në Qendrën për Punë Sociale.

Kryesues i Kuvendit z. Fatmir Ademaj: Fjalën ja kaloj Drejtorit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale z. Amrush Helshani. Urdhëro.

Amrush Helshani(Drejtor për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale):Faleminderit Kryesues,të nderuar Drejtorë,kolegë të Kuvendit.Meqenëse jemi në pragë të Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Malishevës edhe unë shprehi urimet për qytetarët e komunës tonë dhe njëkohësishtë urojë të gjithë personalitetet që u nderuanë me çmimet e Kuvendit Komunal të Malishevës.Në cilësin e Drejtorit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale e marrë fjalën për të arsyetuarë fjalën para juve kërkesën e Qendrës për Punë Sociale dhe propozimin e Kryetarit të Komunës për ditën specifike dhe të rëndësishme Themelimin zyrtar të shërbimit të Kujdestarisë në kuadër të Qendrës për Punë Sociale në komunë të Malishevës.

Kjo pikë ka të bëjë ekskluzivishtë me përmbushjen e një detyrimi ligjor dhe institucional për funksionalizimin e Organit të Kujdestarisë 24 orë në ditë dhe 7 ditë në javë.

Sipas ligjit për shërbime sociale dhe familjare si dhe ligjit për familjet në Kosovë,Qendra për Punë Sociale mbanë rolin ekskluziv për Organin e Kujdestarisë.Ligji e përcaktonë kjo ky organë duhet të jetë në karshi të plotë për të ofruarë mbrojtje juridike dhe sociale të menjëherëshme.

Emërgjencat sociale nuk njohin orar zyrtar kur ligji na obligonë me ndërhyrë si organ i Kujdestarisë ne duhet ta kemi këtë shërbim të ngritur mbi baza të rregullta institucionale dhe jo mbi improvizime.

Në rastet e dhunës në familje,në rastet e fëmijëve të braktisur apo të miturve në rastin e konfliktit me ligjin policia dhe prokuroria nuk mundën me marrë asnjë veprim pa pranimin e përfaqësuesit të Organit të Kujdestarisë.Kur këto raste ndodhin gjatë natës apo në vikend apo edhe në festa,policia ka nevojë imediate për zyrtarin social kujdestarë dhe pa themelimin e këtij shërbimi zyrtar të Organit të Kujdestarisë ne e bllokojmë zingjirin e drejtësisë dhe të sigurisë duke e lënë institucionin pa mbështetje dhe të qytetarëve të cilët kanë nevojë në rrezik.

Statistikat e fundit në komunën e Malishevës tregojnë për një rritje të numrit të vazhdueshme të rasteve emërgjente nga muaji në muaj.

Kjo dinamikë e ka ngarkuarë tejë mase stafin profesional,thirrjet jashtë orarit të punës për rastet e dhunës në familje dhe të miturve në konfliktë me ligjin,tani janë bërë pothuajse të përditshme.

Ky fluks i lartë e bënë të pamundur menagjimin e rasteve në mënyrë vullnetare apo ad hog dhe na duhet një sistem i rregullt dhe i qëndrueshëm i kujdestarisë.

Meqenëse kujdestaria jashtë orarit të punës është përgjegjësi ligjore dhe profesionale ky shërbim duhet të kompenzohet me pagesë sipas ligjeve në fuqi.Qështja e pagesës dhe orëve shtesë të kujdestarisë është e rregulluarë kjo me ligjin e punës dhe ligjin për pagat në sektorin publik në Kosovë.

Duke e themeluarë këtë shërbim me vendim të Kuvendit,ne sigurojmë që puna profesionale e zyrtarëve tanë të paguhet me meritë me buxhetin e para parë komunalë duke e para ndaluarë njëkohësishtë edhe paditë e mundëshme gjyqësore ndaj komunës për mos pagesën e orëve shtesë. Më lejoni që të përmendi përbërjen e Organit të Kujdestarisë siq e keni parë edhe në kërkesën e Qendrës për Punë Sociale.

Në Organin e Kujdestarisë të Qendrës për Punë Sociale propozohenë:

- Afrim Zogaj
- Besjanë Mazreku
- Herolinda Bytyqi
- Hajrije Morina
- Afrime Sulejmani

- dhe një anëtarë rezervë nga Qendra për Punë Sociale.

Të nderuar kolegë Asambleistë ju ftojë të gjithëve që të votoni këtë propozim të Organit të Kujdestarisë të Qendrës për Punë Sociale.Faleminderit.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit Drejtor.Fjalën e ka kërkuarë Hafir Rexha.Urdhëro.

Hafir Rexha(anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):Faleminderit Drejtor.Me të vërtetë Qendra për Punë Sociale ka nevojë për angazhim të madh është punë me orar dhe pa orar vërtetë aty nuk ka orar prej orës 8 deri në ora 4.Dhuna ndodhë në forma të ndryshme,por duke e ditur që gjdo plotësim dhe ndryshim i këtyre rregulloreve ka kosto buxhetore.Unë dëshiroj me pyetur Drejtorin për Ekonomi dhe Financa.

A ka mjete a është parashikuarë sepse nëse ne e votojmë dhe nuk kemi mjete atëherë ne nuk kemi bërë asgjë.Pyetja për Drejtorin e Shëndetësisë është a është e nevojshme që përveq kësaj kjo ta ketë edhe një pako emërgjente?Ka raste që dikush është i dënuar nga familja dhe aty zgjatë me ditë si qëndroni me pakot emërgjente?A keni planifikuarë për pako emërgjente për me ju ndihmuarë këtyre familjeve?Ne shpresojmë që të jenë sa më të pakta në komunën tonë.Faleminderit.

Valjeta Hoti(anëtare nga rradhët e Partisë Demokratike të Kosovës):Faleminderit Drejtorë për shpjegimin e kësaj kërkesë,por në bazë të kësaj kërkesë e vërejtja që është një nevojë sociale dhe ligjore,kjo është në pajtim të plotë me ligjin.

Në bazë të natyrës dhe përgjegjësisë të mëdha që i ka ky organë që hyjnë në kuadrin e kompetencave të këtij organi a ka funksionuarë më herët ky organë i kujdestarisë dhe si janë trajtuarë rastet deri më tani?Faleminderit.

Bashkim Kraniqi(anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):Faleminderit Kryesus.I nderuar Drejtorë të përgëzojë për këtë hap që e ke ndërmarë edhe pse ndoshta ka funksionuarë në mënyrë të ndryshme,shpresojë që tani do të funksiononë më mirë për këtë hap të rëndësishëm që është duke u bërë për shkak të rasteve të ndjeshme që i trajtonë Organi i Kujdestarisë e sidomos te kategoria e fëmijëve të mitur që përballen me probleme të ndryshme familjare dhe me probleme të ndryshme që kanë të bëjnë me vepra penale.

Kështu që unë mendojë që përveq këtij votimi mbështetja ndaj këtij trupi do të bëhet vazhdimishtë kur kemi parasyshë që këta do të punojnë edhe jashtë orarit të rregullt të punës.

Komuna dhe Drejtoria duhet me i dhënë mbështetje sa i përket logjistikës dhe mos me pasur pengesa në realizimin e punës së tyre që ju takonë.

Kështu që kjo kërkesë është e qëlluarë dhe ne do ta mbështesim.

Halil Morina(anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):Faleminderit Drejtor z.Amrush për elaborimin nuk ka dyshim që ky trup është shumë i rëndësishëm për me u funksionalizuarë.

Si komunat e tjera edhe komuna jonë ka probleme të kësaj natyre,ajo qfarë është e rëndësishme për mua dhe që dëshiroj me thënë si kritikë ndaj ekzekutivit që këto qështje kaq të

rëndësishme,këto kërkesa të vijnë me kohë dhe për shkak të rëndësisë së rastit në KPF është dashur me pritur një kohë të gjatë deri sa na ka ardhur kjo kërkesë,këtë pikë e kemi future si urgjente dhe kemi pritur rreth gjysëm ore në KPF derisa të na vijë kërkesa,kjo për shkak të rëndësisë të dokumentit.

Mirëpo këto qështje kaq të rëndësishme sikur ajo që e diskutuamë pak më herët që pajtohemi që ka shumë rëndësi të madhe,por nuk e kuptojë pse nuk ka ardhur si pike në rendin e ditës. Nëse ka diqka që është kaq e rëndësishme duhet herët brenda afateve kohore me dorëzuarë në KPF.

Ne si anëtarë të KPF-së me pasur dokumentin dhe me shqyrtuarë me ditur se qfarë është duke ndodhur dhe pastaj kur vijnë në Kuvend me i pasur gjërat e karta dhe kjo është ndoshta për shkak të neglizhencës dhe unë kisha kërkuarë në përgjithësi pre juve Drejtorëve të Ekzekutivit mos me qenë neglizhentë ndaj këtyre punëve që janë me rëndësi. Gjdo punë që ka të bëjë me juve dhe qytetarët e komunës të Malishevës është punë me rëndësi.Faleminderit.

Veton Zogaj(anëtarë nga rradhët e parties Lëvizja Vetëvendosje):Unë dëshiroj me pyetur Drejtorin meqenëse ka maër iniciativ për themelimin e këtij Organi të Kujdestarisë.A ka shikuarë modalitete të komunave tjera të cilat janë me shumicë shqiptare?

Secila komunë e ka Qendrën për Punë Sociale të vetën,a funksionojnë këto Organe të Kujdestarisë në ato komuna,apo jemi ne të parët?

Nëse kemi ndonjë modalitet të ndonjë komune përkatëse,me ndjekurë shembullin e tyre dhe ne të veprojmë njejetë.Faleminderit.

Amrush Helshani(Drejtor për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale):Faleminderit Kryesues dhe ju të nderuar Asambleistë për pyetjet dhe diskutimet.Zotri Hafir është shumë e nevojshme pakoja emërgjente apo fondi i venqatë për këtë trup,ajo forconë dhe lehtësonë punën e punëtorëve social. Nëse ndodhë ndonjë rast pas mes natës,shpesh viktimat nuk ka asgjë me vete dhe kam pare shumë raporte që shpeshë zyrtarët ndoshta detyrohen me ju blerë një shishe ujë prej buxhetit të vetë edhe me qëndruarë afër viktimës edhe në rastet e tjera kur kemi fëmijë që duhet me i strehuarë,ata kanë nevojë për ushqim për veshmbathje.

Puntorët e Qendrës për Punës Sociale janë të thirrur me qenë prezentë dhe me ju dalur në ndihmë rasteve të dhunës në familje apo rasteve të tjera.

Sa i përket pyetjes së znj.Valjetes unë ju tregova që Qendra për Punë Sociale nuk guxonë me qenë pa punëtorë të kujdestarisë të paktën në këto raste.

Por këtu e kemi edhe një problemë që duhet me na shpjeguarë edhe Drejtori për Ekonomi dhe Financa që unë e përmenda edhe gjatë fjalimit që nuk ka nevojë që një punëtorë në Qendrën për Punë Sociale për punën e vetë që e bënë mos me u paguarë,këtu është problem.

Unë z.Veton e kam një vendim të komunës së Lipjanit që e kemi marrë si shembull sepse e dim që rastet e fundit që kanë ndodhur jo specifikisht në komunën e Malishevës por në përgjithësi në Kosovë të gjitha Qendrat për Punë Sociale e kanë këtë problemë sepse kanë pak puntorë të stafit profesional dhe ballafaqohen me këto nevoja që patjetër duhet me ju dalur në mbështetje puntorëve të Qendrës për Punë Sociale.Gjdo ditë për shkak të ngarkesës së rasteve dhe të ndejshmërisë së rasteve ata po dorëzohenë.

Kështu që unë po besojë që isha i kuartë, pra anën financiare do të dëshiroja shumë nga Drejtori për Ekonomi dhe Financa ta mbështetë këtë kërkesë. Faleminderit.

Enver Hoti (anëtarë nga rradhët e partisë Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës): Drejtor është e domosdoshme kjo punë sepse fatëkeqësisht po shtohen rastet që kanë nevojë për trajtim dhe mbështetje. Kjo kërkesë a është brenda Drejtorisë së Shëndetësisë apo është kërkesë e veçantë, si do të korepsondonë kjo? Le ta kemi të kuartë sepse janë paraqitur disa emra aty.

Amrush Helshani (Drejtor për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale): Ata janë zyrtarë të shërbimit të Qendrës për Punë Sociale.

Enver Hoti (anëtarë nga rradhët e partisë Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës): Unë nuk e kam problemin kush janë ata por e kam problemin të burimi i kohës, por sigurisht ju do ta rregulloni këtë që është më tutje. Të orët shtesë a paguhet kujdestaria? Sepse kjo do të ketë implikime buxhetore por do të kërkonë kushte pune por edhe një buxhet ndoshta pak më të madh, përfshirë edhe pakon emergjente që e përmendi z. Hafir Rexha që është e rëndësishme dhe e domosdoshme. Faleminderit.

Blerim Thaçi (Drejtor për Ekonomi dhe Financa): Kryesues para praktikisht, ju e dini që në kategorinë e pagave dhe shtesave janë të planifikuara të gjitha kategoritë që nënkuptonë edhe pjesën e Qendrës për Punë Sociale për kujdestaritë. Për zyrtarët që i përmendi Drejtori janë katër, ana ligjore ju lejonë vetëm 32 orë në muaj të paguhënë shtesë për vikend, jashtë orarit të punës, ose orarin e natës dhe nuk ka mundësi me u paguarë mbi 32 orë dhe ato duhet me u paguarë me raportë.

Me raportë nënkuptonë që ka pasur ndonjë rast me të cilën e cekun kohën kur kanë dalur që e ka zhvilluar procedurën, në varet sa orë ka punuar për shembull tri ose pesë orë, njëjtë si paguhënë në QKMF njëjtë paguhënë edhe në këtë formë.

Unë dje kam pasur në takim ushtruesen e detyrës Drejtoreshën e QPS-së jemi konsultuarë dhe ma ka prezentuarë një modalitet të komunës së Rahovecit që për mua nuk ishte i mirë sepse nuk mundet me qenë vetëm një herë në javë përfaqësuesi sepse rastet munden me ndodhur në ditën e shtunë ditën e diel dhe duhet me qenë prezentë përfaqësuesi i saj.

Mirëpo është edhe një gjë tjetër, 8 orë pune të rregullta, 16 orë kujdestari me dy ditë ai i mbyllë 32 ditë ai nuk ka të drejtë i bie 4 vikende i mbesin 8 ditë afërsisht 23 ditë pa u përfshirë është problem i menaxhimit të Drejtorisë.

Unë e kam propozuarë një model të saj janë katër ose tre veta të secili nga 8 orë ai mundet mos me ardhur nesër në punë se e ka ndrimin e kujdestarisë prej orës 24 deri në ora 08:00 të mëngjesit dhe nuk ka nevojë me u lajmëruar, duhet secili me qenë me një zyrtarë aktiv për raste të tilla, ndryshe me këtë staf me katër veta që janë nuk mundesh me i mbuluarë me kujdestarinë që e ke kërkojnë. Drejtoresha e tha edhe një gjë neve na shkrunaë që jemi kujdestarë edhe pse jemi në shtëpi prej orës 4.

Amrush Helshani (Drejtor për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale): Mirëpo ata janë në gjendje gatishmërie.

Blerim Thaçi(Drejtor për Ekonomi dhe Financa):Ata janë në gjendje gatishmërie,por pa pasur punë nuk paguhet,në gjendje gatishmërie është edhe Inspektoriati,nëse ndodhë ndonjë aksident në mes natës në ora 02:00,ata kanë me dalur në atë kohë dhe pastaj kanë me krijuarë raportin që e ka thirrur Prokurori dhe pastaj e paguajnë.Nuk ka kuptim ata me sjellur raportin që kanë qenë kujdestarë prej orës 16:00 deri në mëngjes të orës 08:00 dhe punë nuk ka pasur,janë para parë vetëm 32 orë me u paguarë më shumë jo.

Hafir Rexha(anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):Zyrtarët e Qendrës për Punë Sociale duhet me qenë e kuartë zotri Drejtor,aty ju shenon kujdestarë që është i gatshëm 24 orë,por nuk nënkuptonë kur ai nuk ka marrë pjesë me u paguarë.Ai paguhet vetëm me raportë të detajuarë,kështu që është shumë e rëndësishme për me qenë kjo,ne do ta hedhim në votim mirëpo kujdestarë me nejtë në shtëpi edhe me u paguarë nuk ka,kujdestarë paguhet me raport që ka punuarë në terren dhe kohë të caltuarë.Faleminderit.

Kryesuesi i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Meqenëse nuk ka më për debatë,këtë pjesë e rregullonë Drejtoria për Ekonomi dhe Financa me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale kjo qështje është në mes të ekzekutivit,ne e hedhim në votim kërkesën.Kush është për?

Rezultati i votimit:20 për,0 kundër,0 abstenime.

Kryesuesi i Kuvendit konstatoi që u miratua unanimitë nga anëtarët e Kuvendit kërkesa për funksionimin e Organit të Kujdestarisë në Qendrën për Punë Sociale.

Pika 5

Pika e pestë e rendit të ditës:Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:A ka dikush me marrë fjalën për këtë pikë të rendit të ditës?Meqenëse nuk ka me marrë fjalën,ju falenderoi të gjithëve për angazhimin dhe pjesëmarrjen tuaj.

Kryesuesi i Kuvendit i mbylli punimet e mbledhjes së -III-(tretë) të jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës në ora 12:00 min.

Malishevë

Procesëmbajtësja

Kryesuesi i Kuvendit

Fatlume Delija

Fatmir Ademaj

